



Bruksel, 16.10.2013  
COM(2013) 700 final

## **RAPORT NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN**

### **Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014**

{SWD(2013) 411 final}  
{SWD(2013) 412 final}  
{SWD(2013) 413 final}  
{SWD(2013) 414 final}  
{SWD(2013) 415 final}  
{SWD(2013) 416 final}  
{SWD(2013) 417 final}  
{SWD(2013) 418 final}

## TË DREJTAT THEMELORE – SUNDIMI I LIGJIT, DEMOKRACIA DHE EKONOMIA

### I. AGJENDA E ZGJERIMIT

Njëzet vjet më parë, Ballkani Perëndimor ishte i shkatërruar nga konflikti. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian ra dakord me kushtet, të njohura si kriteret e Kopenhagës për hyrjen e vendeve të ardhshme Anëtare në BE. Kriteret e Kopenhagës reflektojnë rregullat mbi të cilat është krijuar BE-ja: demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave themelore, si dhe rëndësia e një ekonomie funksionale të tregut. Kjo ka trasuar rrugën për transformimin dhe pranimin historik të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Dhjetë vjet më vonë, në samitin e Selanikut në vitin 2003, BE-ja u ofroi të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor një perspektivë të qartë të anëtarësimit në BE, varësisht nga përmbushja e kushteve të nevojshme, në veçanti të kriterit të Kopenhagës dhe kushteve të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA).

Kroacia i ka plotësuar këto kushte. Pas ratifikimit të Traktatit të Anëtarësimit nga të gjitha vendet anëtare, Bashkimi Evropian mirëpriti Kroacinë si vendi i 28 anëtar më 1 korrik të vitit 2013. Kroacia është vendi i parë që përfundoi Procesin e Stabilizim Asociimit. Pranimi i Kroacisë është një shembull i fuqisë transformuese dhe efektit stabilizues të procesit të zgjerimit dhe fuqisë së butë të BE-së.

Marrëveshja historike e arritur në muajin prill nga **Serbia** dhe **Kosova\*** është provë e mëtejshme e forcës së perspektivës të BE-së dhe roli i saj në shërimin e plagëve të thella historike. Ajo gjithashtu, në mënyrë vendimtare, reflekton kurajon e liderit politik në të dyja vendet. Në qershor, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e pranimit me Serbinë dhe Këshilli autorizoi hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Ky ka qenë një vit i rëndësishëm për vendet e tjera në zgjerim:

Në qershor të vitit 2013, **Mali i zi** miratoi planet e përgjithshme të veprimit për kapitujt mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore si dhe mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, në përputhje me qasjen e re për të trajtuar këta kapituj më herët në procesin e pranimit. Në **Shqipëri**, mbështetja ndër-partiake për reformat kyçe, zhvillimi i rregullt i zgjedhjeve parlamentare dhe hapat e tjerë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nënkupton se statusi i kandidatit tani është brenda mundësive. **Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë** ka dalë nga kriza e saj politike në fillim të vitit, por ende mbeten shqetësime, sidomos sa i përket lirisë së shprehjes dhe mediave. Janë ndërmarr hapa për të përmirësuar marrëdhëniet e mira fqinjësore. Më gjerësisht, tash është i rëndësishëm përparimi i madh në bisedimet e lehtësuara nga KB-ja mbi emrin. Në **Bosnje dhe Hercegovinë**, mungesa e vullnetit politik për të zbatuar reformat dhe dështimi për të zbatuar vendimin e Sejdic-Finci është duke penguar progresin e vendit drejt BE-së si dhe zhvillimin ekonomik.

Në **Turqi**, ka pas përparime në reformat e gjyqësorit dhe reformat e tjera si dhe pakoja e shumë pritur e demokratizimit është prezantuar në shtator. Bisedimet për paqe me PKK-në janë përcjell më një synim për të përfunduar terrorizmin dhe luftën në juglindje të vendit, duke përgatitur terrenin për zgjidhjen e çështjes së kurdëve. Megjithatë, trajtimi i demonstratave si përgjigje për propozimin e krijimit të Gezi Parkut në Stamboll ka ngritur shqetësime serioze dhe ka nënvizuar nevojën që BE-ja të mbetet spirancë për reforma.

---

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozitës së statusit, dhe është në përputhje me RKSKB1244/99 dhe me mendimin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë.

Sa i përket **Islandës**, qeveria e re i ka vënë në pritje negociatat për pranimin në BE dhe ka deklaruar se negociatat nuk do të vazhdojnë pa referendum.

**Procesi i pranimi** në ditët e sotme është më rigoroz dhe më gjithëpërfshirës se sa në të kaluarën. Kjo reflekton në evolucionin e politikave të BE-së si dhe në mësimet e marra nga zgjerimet e mëhershme. Procesi është i ndërtuar në kushtëzimin e rreptë por të drejtë me progresin drejtë anëtarësimit që varet nga hapat e ndërmarrë nga secili vend për të plotësuar kriteret e vendosura. Një mësim i rëndësishëm nga e kaluara është rëndësia e adresimit të **drejtave themelore**.

**Sundimi i ligjit** është tani në zemër të procesit të zgjerimit. Qasja e re, e miratuar nga Këshilli në dhjetor të vitit 2011, nënkupton se vendet duhet të trajtojnë çështjet e tilla si reformat gjyqësore dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në fillim të negociatave për anëtarësim. Kjo e maksimizon kohën që vendet e kanë për të zhvilluar një regjistër të qëndrueshëm të zbatimit të reformave, duke u siguruar që reformat të jenë rrënjësore dhe të pakthyeshme. Kjo qasje e re është një element kyç i kornizës negociuese për Malin e Zi dhe do t'i japë formë punës së Komisionit me vendet e tjera në zgjerim.

Kriza globale ekonomike e pesë viteve të fundit ka nënvizuar nevojën, për të gjitha vendet, për të rishikuar dhe fuqizuar në mënyrë thelbësore **udhëheqjen e tyre ekonomike**. Kjo vlen në veçanti për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku asnjëra prej tyre nuk kanë një ekonomi funksionale të tregut. Të gjithë janë të prekur nga papunësia e lartë, sidomos tek të rinjtë. Është me rëndësi vitale që këto vende të intensifikojnë reformat për t'u kthyer në një rritje të qëndrueshme dhe të adresojnë sfidat e nevojshme për të plotësuar kriterin ekonomik dhe për të përmirësuar konkurrencën. Ky Komunikim përcakton propozimet për ta përkrahur këtë synim, duke përfshirë edhe futjen e strategjive për reforma ekonomike kombëtare dhe të planeve të veprimit për menaxhimin financiar publik

Ngjarjet në një numër të vendeve në zgjerim kanë nënvizuar rëndësinë e **fuqizimit të institucioneve demokratike** dhe sigurimit të proceseve përfshirëse demokratike që i përkrahin këto institucione dhe i përforcojnë parimet thelbësore demokratike dhe vlerat e përbashkëta të BE-së. Një rol më i fuqishëm për shoqërinë civile është kyç, siç janë edhe platformat ndër-palëshe për integrimin në BE dhe për progres të mëtejshëm me reformat zgjedhore, parlamentare dhe të administratës publike.

Bashkimi Evropian është i krijuar në vlerat dhe parimet e përbashkëta, duke përfshirë respektin për të **drejtat themelore**. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia duhet të ndërmarrin reforma të mëtejshme për t'u siguruar që parimet e lirisë së shprehjes dhe mbrojtja e të drejtave të personave që i takojnë minoriteteve, duke përfshirë komunitetin Romë të respektohen në praktikë, jo vetëm të integrohen në ligj. Masa më të forta janë të nevojshme për të mbrojtur grupet e tjera të rrezikuara nga diskriminimi, në veçanti sa i përket orientimit seksual.

**Marrëdhëniet e mira fqinjësore** dhe bashkëpunimi rajonal janë elemente thelbësore të procesit të Stabilizim Asociimit. Zhvillimet në Serbi dhe në veçanti në Kosovë kanë treguar se vendet mund të bëjnë progres në lidhje me tejkalimin e konfliktit të fundit, në përputhje me parimin mbi të cilin është themeluar Bashkimi Evropian. **Bashkëpunimi rajonal** duhet të forcohet më shumë, të jetë më përfshirës dhe me pronësi rajonale. Komisioni e përkrah plotësisht punën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës juglindore (PBEJL) dhe Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit, duke përfshirë strategjinë Rajonale 2020. Duhet të ekzistoj një përpjekje e përtërirë për t'i tejkualuar **konfliktet bilaterale** në mes të vendeve në zgjerim me vendet anëtare. Çështjet bilaterale duhet të adresohen nga palët e përfshira sa më herët që të jetë e mundur dhe nuk duhet të ngadalësojnë procesin e pranimi.

Viti 2014 parasheh nisjen e **Instrumentit të dytë për Asistencë të Para-anëtarësimit**. Përmes IPA II, BE-ja do të vazhdojë të ofroj ndihmë substanciale për vendet në zgjerim në

përgatitjet e tyre për pranim, me një nivel të krahasueshëm të fondeve për periudhën 2014-2020 (11.7 miliard € në çmimet aktuale) njësoj si në kornizën e tashme financiare. IPA II gjithashtu do të përkrah bashkëpunimin rajonal si dhe atë ndër-kufitarë. IPA II do të fokusohet në fusha të interesit të përbashkët, në veçanti për të përkrahur reformat dhe zbatimin e tyre të qëndrueshëm në fushën e sundimit të ligjit, për të forcuar institucionet demokratike dhe qeverisjen e mirë si dhe në zhvillimin socio-ekonomik.

Nisja e IPA II është gjithashtu një mundësi për të siguruar një lidhje edhe më të afërt në mes të strategjisë për zgjerim dhe prioritetëve për asistencë. IPA II prezanton disa inovacione të rëndësishme, kryesisht duke u përqendruar në definimin e politikave dhe strategjive afatgjata në një numër të kufizuar të sektorëve prioritarë, të cilët do të renditen me nevojat dhe kapacitetet e secilit vend. Synime të qarta dhe tregues real do të krijohen dhe do të lidhen me ndihmën shumë-vjeçare të sektorit. Nëse vendet plotësojnë standardet e nevojshme të menaxhimit financiar publik, ata mund të jenë në gjendje të përfitojnë nga ndihma buxhetore – një nxitës shtesë për reforma. Stimulimet do të jenë në dispozicion për vendet të cilat përparojnë në rrugën e tyre të reformimit. Në rast të mos-performancës, fondet do të rialokohen. Menaxhmenti i programeve të IPA-së do të jetë edhe më i efektshëm, kryesisht me më pak projekte por të një volumi më të madh.

Të gjitha vendet në zgjerim kanë një **perspektivë të qartë Evropiane**. Progresi drejt anëtarësimit varet nga hapat e ndërmarr, nga secili vend, për të plotësuar kriteret e vendosura, bazuar në parimet e meritave të veta. Kjo është esenciale për kredibilitetin e politikave për zgjerim dhe për ofrimin e stimulimeve për vendet që t'i ndjekin reformat e gjera. Në të njëjtën kohë, është esenciale për vendet anëtare, së bashku me institucionet e BE-së, të udhëheqin një debat të informuar mbi ndikimet politike, ekonomike dhe sociale të politikës së zgjerimit. Ata kanë një rol kyç në ofrimin e fakteve mbi politikën e zbatimit për qytetarët, dhe duke bërë këtë, të informojnë ata për përfitimet, duke përfshirë kontributet madhore për paqen, sigurinë dhe mirëqenien, dhe të adresojnë çfarëdo shqetësimi që ata mund të kenë.

## **II. SFIDAT KRYESORE**

Në këtë Komunikatë, Komisioni nënvizon një numër të sfidave kyçe me të cilat përballet Ballkani Perëndimor dhe Turqia: administrimi ekonomik dhe konkurrenca; sundimi i ligjit; funksionimi i institucioneve që garantojnë demokracinë; të drejtat themelore; dhe, në rastin e Ballkanit Perëndimor, tejkalimi i trashëgimisë nga e kaluara. Këto sfida janë të rëndësishme për kriteret e Kopenhagës dhe kushtëzimet e procesit të Stabilizim Asociimit. Masat për të adresuar këto sfida përforcohen në mënyrë reciproke. Për shembull, promovimi i sundimit të ligjit dhe garantimi i të drejtave themelore, rritja e sigurisë ligjore së bashku me integrimin më të thellë rajonal, kontributi i konsiderueshëm për përkrahjen e zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës.

### **a) Administrimi ekonomik dhe konkurrenca**

Në tre vitet e ardhshme, BE-ja ka fuqizuar ndjeshëm qeverisjen e saj ekonomike. Në gjashtëmujorin Evropian, vendet anëtare koordinojnë politikat fiskale dhe strukturore para se parlamentet përkatëse të miratojnë buxhetet e tyre kombëtare. Mjetet e dialogut ekonomik me vendet në zgjerim janë gradualisht duke ju përshtatur sfidave të reja dhe mekanizmave koordinues të BE-së. Vendeve tashmë i'u është kërkuar të vënë më shumë theks në qëndrueshmërinë e pozitës së tyre të jashtme dhe në pengesat kryesore strukturore për rritjen. Është e rëndësishme që tani të pasqyrojmë më plotësisht instrumentet kryesore të BE-së në dialogu politik duke pasur parasysh faktin se sa janë vendet në zgjerim të integruar ekonomikisht dhe financiarisht në BE.

BE-ja është destinacioni për së paku 60% të eksportit nga Ballkani Perëndimor. BE-ja është ofruesi më i madh i investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Me përjashtim të Turqisë, bankat e BE-së dominojnë sektorin financiar. Qasja në tregun e vetëm të BE-së për mallra dhe shërbime ofron një rrugë të rëndësishme për rritje. Rigjenerimi në BE gjithashtu do të ketë një ndikim pozitiv sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor. Parashikimi më i fundit i

Komisionit është që Ballkani Perëndimor duhet të rritet për 2% në vitin 2013. Parashikimi për Turqinë është 3.2%, duke treguar një kthim në normat më të larta të rritjes pas një ngadalësimi relativ në vitin 2012.

Rimëkëmbja modeste në Ballkanin Perëndimor nuk është garanci për rritje të qëndrueshme dhe konvergjencë. Sfida të konsiderueshme mbeten në të gjitha vendet në zgjerim sa i përket reformës ekonomike, konkurrencës dhe krijimit të vendeve të punës:

- Përderisa Turqia është një treg funksional i ekonomisë, asnjë nga vendet në zgjerim në Ballkanin Perëndimor nuk e gëzon këtë status.
- Sistemi i menaxhimit financiar publik duhet të fuqizohet në mënyrë të konsiderueshme për të zvogëluar rrezikun e mashtrimit dhe korrupsionit.
- Sundimi i ligjit duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme për të ofruar siguri më të madhe ligjore për operatorët ekonomik dhe për të rritur besimin e investuesve.
- Reformat strukturore duhet të prioritetizohen dhe konkurrenca të përparohet në mënyrë që të përkrah konsolidimin fiskal, të trajtoj mos-balancat e mëdha të jashtme si dhe papunësinë e lartë në të gjitha vendet, me një mesatare mbi 20% në Ballkanin Perëndimor. Ka dallime të konsiderueshme regjionale brenda vendeve, me nivel më të larta të varfërisë në zonat rurale.

Është propozuar një qasje e re për të ndihmuar vendet në zgjerim që të trajtojnë bazat ekonomike dhe të përmbushin kriteret ekonomike. Vendet do të ftohen që të përmirësojnë politikat ekonomike dhe qeverisjen e tyre përmes përgatitjeve të koordinuara të strategjisë për reformën ekonomike që përbëhet nga dy elemente - një program makro-ekonomik dhe fiskal si dhe një program për reformën strukturore dhe të konkurrencës. Këto do të trajtohen në dialogun dypalësh edhe në atë shumë-palësh me vendet:

- Programi makroekonomik dhe fiskal do të vazhdojë të trajtohet përmes instrumenteve ekzistuese, respektivisht Programeve Ekonomike për Para-Anëtarësim për vendet kandidatë dhe Programet Ekonomike dhe Fiskale për vendet e mundshme kandidatë. Për të përforcuar mbikëqyrjen, Këshilli i përbashkët i ECOFIN-it me vendet kandidatë do të ftohen për të ofruar udhëzime më të shënjestruara politike përmes rekomandimeve specifike për vendet dhe për të ndërmarrë një rishikimi vjetor dhe inventarizimin e zbatimit të politikave.
- Si një element i ri, vendeve do t'u kërkohet të zhvillojnë programe për reformat strukturore dhe të konkurrencës. Këto programe do të përgatiten paralelisht me programet fiskale, por më vonë do të rishikohen në kontekstin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit nga organet përkatëse, më së shumti në fushat e industrisë, konkurrencës, tregut të brendshëm, hulumtimeve, arsimimit, transportit, energjisë dhe mjedisit. Për më tepër, Komisioni do të shfrytëzojë raportet e progresit vjetor për të dhënë një udhëzim të qartë mbi reformat e nevojshme për arritjen e suksesit të mëtejshëm në plotësimin e kriteve ekonomike.

Komisioni gjithashtu do të angazhohet në dialogun mbi menaxhimin financiar publik me vendet në zgjerim, të cilët do të , *ndër të tjera*, përkrahin progresin në drejtim të plotësimin të kriteve ekonomike. Vendet duhet të hartojnë planet e veprimit në këtë fushë, të cilat do të monitorohen nga Komisioni. Progresi në drejtim të menaxhimit financiar publik në mënyrë efektive gjithashtu do të hapë mundësinë e mbështetjes financiare të sektorit, siç është parashikuar në IPA II.

Komisioni do të avancojë këtë qasje në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse ndërkombëtare financiare dhe do të ofrojë asistencë të përgjithshme teknike regjionale në këtë aspekt. Rekomandimet e Komisionit për kriteret ekonomike do të ofrojnë udhëzime në lidhje me fushëveprimin e kësaj asistence teknike.

### *Masat tjera për nxitjen e konkurrencës, investimeve, rritjes dhe punësimit*

Mbështetja e komisionit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Ballkanin Perëndimor shkon përtej stabilizimit makro-ekonomik dhe arritjes së statusit të një ekonomie funksionale të tregut. Që nga fillimi i krizës, Komisioni ka insistuar që më shumë duhet të bëhet për të adresuar gjendjen e vështirë socio-ekonomike, në veçanti papunësinë e lartë. Komisioni gjithashtu nënvizoi nevojën për të mbështetur investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Transporti ndër-kufitar, energjia dhe rrjetet e komunikimit janë të pazhvilluara. Në pikëpamje të madhësisë së ekonomive të Ballkanit Perëndimor, çelësi i tërë kësaj është integrimi më i afërt. Bashkëpunimi ekonomik regjional është parë si një mundësi për rritje dhe bazë për një bashkëpunim politik dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Liberalizimi i planifikuar i shërbimeve në Zonën e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) do të mbështeste edhe më shumë këtë qëllim. Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe atij fizik në zonat rurale dhe miratimi i mëtejshëm i standardeve të BE-së në sektorin e agro-ushqimit do të kontribuojnë në konkurrueshmërinë e sektorit regjional të bujqësisë.

Komisioni tashmë ka filluar një dialog të ri mbi programet e reformave të punësimit si dhe ato sociale me Turqinë dhe Serbinë. Dialogu me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi do të pasojë. Situata socio-ekonomike në kandidatët potencial është më sfiduese se sa në vendet kandidate dhe do të nevojitet mbështetje shtesë për të ngritur kapacitetet administrative për të lehtësuar pjesëmarrjen në procesin e ri. Kandidatët potencial do të ftohen gradualisht në dialogun e ri. Asistenca gjithëpërfshirëse teknike do të programohet në vitin 2014, me theks të veçantë në vendet potenciale për kandidaturë. Komisioni do të vazhdojë të zhvillojë platformën e Ballkanit Perëndimor mbi arsimin dhe aftësimin me synimin për të reduktuar boshllëkun e aftësive dhe përmirësimin e sistemit arsimor.

Nën patronazhin e Këshillit Regjional të Bashkëpunimit (KRB), grupet regjionale të themeluara sipas agjendës së Selanikut kanë filluar të adresojnë prioritetet Evropa 2020. Që është një strategji regjionale në zhvillime e sipër për vitin 2020. Duhet të bëhet më shumë për të ngritur vetëdijen dhe kapacitetet e grupeve aktualisht të shpërndara ashtu që ata të mund të angazhohen në rishikimet e rregullta të kolegëve të tyre dhe të bëjnë rekomandime. KBR-ja duhet të zhvillojë një mekanizëm publik të monitorimit. Gjetjet nga grupet dhe mekanizmi monitorues do të përcjellët nga Komisioni në dialogun e tij ekonomik dhe në procesin e programimit të IPA-së.

Reformat që dërgojnë në plotësimin e kriterit ekonomik gjithashtu do të mbështeten nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). WBIF-ja luan një rolë gjithnjë e më të rëndësishëm në ndihmën e përgatitjes së ndihmës në këto investime të nevojshëm për nxitjen e rritjes dhe punësimit. Në kuadër të WBIF-së, Komisioni, donatorët bilateral dhe institucionet ndërkombëtare financiare janë duke përkrahur investimet me vlerë 4 miliard euro për vit në sektorin e transportit, energjisë, mjedisit, ndryshimit klimatik, zhvillimin e sektorit social dhe sektorit privat/NVM-ve, ku Komisioni është duke bashkë-financuar një platformë të Ballkanit Perëndimor të NVM-ve që synon përmirësimin e qasjes në financa për NVM-të përmes garancive dhe kapitaleve.

Përmirësimi i transportit dhe ndërlidhjeve të energjisë në mes të BE-së dhe vendeve në zgjerim do të jetë prioriteti kyç për promovimin e një rritje të qëndrueshme ekonomike, punësimit, tregtisë dhe shkëmbimit kulturor. Komisioni nënvizon rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës energjetike Trans-Evropiane dhe bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë. Traktati i ardhshëm i Komunitetit të Transportit do të promovojë integrimin e tregjeve dhe infrastrukturës të transportit rrugor përderisa i ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e standardeve të transportit tokësor të BE-së. Komisioni ka rishikuar rrjetet Trans-Evropiane të BE-së në fushën e transportit (TEN-T) dhe energjisë (TEN-E) me synim të

përmirësimin të lidhjeve me vendet e mbuluara nga zgjerimi dhe politikat fqinjësore. Në këtë drejtim, Komisioni ka miratuar një listë të Projekteve me Interes të Përbashkët (LPP) për zhvillimin e infrastrukturës energjetike Trans-Evropiane. Një listë e Projekteve të Interesit të Komunitetit të Energjisë (PIKE) duhet të miratohet nga Këshilli i ardhshëm Ministror i Komunitetit të Energjisë.

Bashkëpunimi me Turqinë do të rritet, jo për shkak të vendndodhjes së saj strategjike dhe potencialit si një qendër e energjisë. Në vitin 2013, Turqia e ka ratifikuar Marrëveshjen e Tubacionit Trans-Anatolian që synon lidhjen me Tubacionin Trans-Adriatik, duke sjellë kështu gazin natyral në Evropë nga Kaspiku përmes Turqisë. Në këtë kontekst, forcimi i bashkëpunimit BE-Turqi për energjinë si dhe progresi përkatës në negociatat për praninë do të lehtësojë progresin e mëtejshëm në drejtim të ndërlidhjes dhe integritetit të tregjeve të energjisë së BE-së dhe Turqisë. Komisioni mirëpret vlerësimin nga Banka Botërore që rishikon bashkimin doganor në mes të BE-së dhe Turqisë. Ky vlerësim, i kontraktuar nga Komisioni Evropian, do të bëjë rekomandime për përmirësimin e funksionimit dhe zgjerimin e mundshëm të fushëveprimit të saj.

#### **Për të mbështetur punën në sfidat e mësipërme, Komisioni do të:**

- Ftojë vendet në zgjerim për të përgatitur një strategji për reformim ekonomik kombëtar që përbëhet nga dy elemente - programin ekzistues makro-ekonomik dhe fiskal dhe një reformë të re strukturore dhe programin e konkurrencës. Procesi do të rezultojë me rekomandime specifike për vendin dhe një udhëzim i qartë mbi veprimet e nevojshme për të arritur progres të mëtejshëm duke u bërë një treg ekonomik funksional si dhe përmirësimi i konkurrencës.
- Nisë një dialog me vendet mbi kushtet e nevojshme për të përmbushur standardet e menaxhimit të financave publike, të përgatisë terrenin për mbështetjen e mundshme të IPA-së për buxhetin.
- Të ofroj asistencë gjithëpërfshirëse teknike në bashkëpunim të ngushtë me organizatat tjera ndërkombëtare.

Në periudhën 2007-2013, janë ofruar deri në 190 milion € si asistencë e para-anëtarësimit për t'i forcuar kapacitetet institucionale të qeverisë në fushat e tilla si menaxhimi i fondeve publike, politikat dhe statistikat ekonomike dhe fiskale si dhe kapacitetet institucionale të bankave kombëtare.

**Përmes IPA II**, Komisioni do të vazhdojë të mbështes reformat që dërgojnë në përmbushjen e kriterëve ekonomik dhe zhvillimit socio-ekonomik, përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), duke prioritetizuar përmirësimet në ndërlidhjet transportuese dhe energjetike në mes të BE-së dhe vendeve në zgjerim, dhe të ofroj asistencë teknike për të mbështetur menaxhimin ekonomik, dialogun mbi punësimin dhe çështjet sociale, objektivat e KRB-së mbi strategjinë regjionale 2020, bujqësinë dhe zhvillimin rural.

#### **b) Sundimi i Ligjit**

Sundimi i ligjit është një vlerë themelore mbi të cilën BE-ja është e themeluar. Ruajtja e vlerave, siç është sundimi i ligjit, është ajo për çfarë është krijuar të bëjë Bashkimi Evropian, që nga fillimi i tij e deri tek kapitujt e tij të fundit të zgjerimit. Sundimi i ligjit mbetet prioritet për BE-në dhe është **në zemër të procesit të anëtarësimit**, një shtyllë kyçe e kriterëve politike të Kopenhages. Vendet që aspirojnë t'i bashkohen Bashkimit Evropian duhet të krijojnë dhe promovojnë që nga faza e hershme funksionimin e institucioneve kyçe që janë të nevojshme për sigurimin e sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit mbështet mjedisin e biznesit, duke ofruar siguri ligjore për operatorët ekonomik dhe stimulimin e investimeve, punës dhe rritjes. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësorë për t'iu kundërvënë infiltrimit kriminal në sistemet politike, ligjore dhe ekonomike. Në shumicën e vendeve në zgjerim ka nevojë për reforma gjithëpërfshirëse, transparente dhe ambicioze me synim të sigurimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, paanshëm, efikas dhe të përgjegjshëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet emërimit, vlerësimit dhe procedurave disiplinore për gjykatësit.

Ekziston nevoja për të krijuar një kornizë më të fortë për trajtimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, që mbetet një shqetësim serioz në shumë vende në zgjerim. Janë të nevojshme përpjekjet për të siguruar një regjistër të qëndrueshëm të rezultateve thelbësore në këtë fushë bazuar në hetime efikase, efektive dhe të paanshme, ndjekja penale dhe vendimet e gjykatave për rastet e të gjitha niveleve, duke përfshirë këtu edhe korrupsionin e nivelit të lartë.

**Procesi i liberalizimit të vizave** ka nxitur vendet e Ballkanit Perëndimor të hedhin hapat themelore për të reformuar ato aspekte që janë të lidhura ngushtë me procesin e liberalizimit të vizave. Këto reforma kanë fuqizuar qeverisjen e brendshme. Vendet duhet të shtojnë përpjekjet për të konsoliduar ato reforma dhe për të zbatuar masat për të parandaluar abuzimin e regjimit të liberalizimit të vizave siç është përshkruar dhe rekomanduar nga Komisioni në raportet e monitorimit pas liberalizimit të vizave. Komisioni do të prezantoj raportin e katërtë të këtij lloji deri në fund të vitit 2013. Çështjet e migrimit dhe menaxhimit të kufijve do të vazhdojnë të adresohen në forumet e duhura, siç është korniza e MSA-së, dhe përfshirja në kapitullin e 24 për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

Është duke u zbatuar **një Qasje e re në negociatat për anëtarësim** mbi sistemin gjyqësorë, të drejtat themelore, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Duke u bazuar në mësimet e nxjerra, qasja e re prezanton nevojën që të zhvillohen regjistra të qëndrueshëm të zbatimit të reformave për gjatë gjithë procesit. Trajtimi i këtyre fushave në fillim të negociatave ofron kohë maksimale që vendet në zgjerim të sigurohen që reformat të jenë të rrënjësura dhe të pakthyeshme. Qasja e re tani është duke u zbatuar në negociatat me *Malin e Zi*, që ka përgatitur një plan gjithëpërfshirës të veprimit si bazë për hapjen e negociatave për këto kapituj. Pas ftesës nga Këshilli Evropian në qershor të vitit 2013, qasja e re është duke u integruar plotësisht në kornizën negociuese për *Serbinë* dhe monitorimi i kapitujve 23 dhe 24 është në proces e sipër.

Sundimi i ligjit është gjithashtu një temë kyçe e **marrëdhënieve të BE-së me vendet e tjera në zgjerim**. Dialogu i nivelit të lartë për anëtarësim i Komisionit me *Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* vazhdon të trajtoj çështjet e sundimit të ligjit. Një numër i prioriteteve kyçe të Opinionit të Komisionit për vitin 2010 që përcakton kushtet për hapjen e negociatave për anëtarësimin e *Shqipërisë* kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Komisioni do të përkrah reformat gjyqësore përmes Dialogut të tij të strukturuar mbi drejtësinë me *Bosnjën dhe Hercegovinën* dhe gjithashtu mbanë një Dialog të strukturuar me *Kosovën*, duke u fokusuar në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit si dhe reformat e sistemit gjyqësorë. Sundimi i ligjit gjithashtu është prioritet sipas agjendës pozitive me Turqinë.

#### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Zbatoj qasjen e re në kapitujt për gjyqësinë, të drejtat themelore dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë me *Malin e Zi* dhe *Serbinë* dhe të vazhdoj me prioritizimin e sundimit të ligjit përmes dialogut të shënjestruar me vendet e tjera në zgjerim
- Siguroj bashkëpunim me agjencitë përkatëse Evropiane ( në veçanti me Europol-in, Eurojust-in dhe Frontex-in) dhe të inkurajoj bashkëpunimin e forcuar në mes të këtyre agjencive dhe vendeve në zgjerim, duke përfshirë përfundimin e marrëveshjeve funksionale me Europol-in.
- Fuqizon mbështetjen për reformat që ndërlidhën me sundimin e ligjit përmes IPA II në të nivelet: kombëtar dhe rajonal, për të futur reformat në këto fusha kyçe dhe për të siguruar shkëmbimin e përvojave më të mira efektive në themelimin e regjistrave në trajtimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Në periudhën 2007-2013, mbi 800 milion € në ndihmë para-anëtarësim është siguruar për të përmirësuar sektorin e drejtësisë, pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe menaxhimin dhe sigurinë e kufijve. **Përmes IPA II**, strategjitë e sektorit do të zhvillohen me një fokus të veçantë në zhvillimin e një gjyqësori të pavarur, efikas dhe profesional dhe të përkrah zhvillimin e një kornize të fuqishme në nivel kombëtar dhe regjional dhe një regjistri të zbatimit të luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Kjo përfshinë masat e parandalimit dhe ofrimin e organeve për zbatimin e ligjit me mjete



efikase ligjore dhe hetuese, në veçanti kapacitetin për të kryer hetimet financiare

### c) **Funksionimi i institucioneve të cilat garantojnë demokracinë**

Kriteret politike të Kopenhagës kërkojnë nga vendet candidate të arrijnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë. Funksionimi i duhur i institucioneve thelbësore është jetik, qoftë parlamenti, qeveria apo administrata publike. Transparenca, përgjegjshmëria dhe efikasiteti i institucioneve dhe administratës publike, duke përfshirë një përqendrim më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve, duhet të prioritetizohen në shumicën e vendeve në zgjerim. Duhet të bëhet më shumë për të forcuar demokracinë pjesëmarrëse dhe krijimin e platformave kombëtare të ndërlidhura me reformat e BE-së që ndërtojnë një konsensus në mes të palëve dhe shoqërisë së gjerë për të përkrahur reformat e nevojshme madhore. Vendet gjithashtu duhet të gjejnë një balancë të duhur në mes të **qeverisë qendrore, regjionale dhe lokale** që e mbështet në mënyrën më të mirë zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Gjithashtu është i rëndësishëm roli i autoriteteve regjionale dhe lokale në procesin e përafrimit të BE-së dhe aplikimit eventual të rregullave të BE-së.

Institucionet demokratike mbeten të brishta në një sërë vendesh në zgjerim. Mungon kultura e ndërtimit të konsensusit, ku është i pazhvilluar roli i **parlamenteve kombëtare**. Demokracia është më shumë se kryerja e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Është për institucione të forta, të përgjegjshme dhe për procese pjesëmarrëse, të përqendruara në parlamentet kombëtare. Mbikëqyrja parlamentare shpesh është e penguar nga përdorimi i tepërt i procedurave urgjente të legjislacionit, sistemeve dhe procedurave të dobëta të komisioneve parlamentare dhe konsultimet e pamjaftueshme me palët e interesit, me të dhëna minimale nga ekspertët.

Zgjedhjet shpesh shihen si mundësi për të përfutur kontroll politik mbi institucionet shtetërore përtej dorëzimit legjitim të fuqive politike të ndërlidhura me ndryshimin e administratës. Në shumë raste, edhe pozitat relativisht të ulëta në administratën publike janë të ndikuara politikisht. Kjo dëmton kapacitetin dhe përgjegjshmërinë e administratës. **Reforma e administratës publike** është jetike, duke përfshirë profesionalizimin dhe de-politizimin e shërbimit civil. Futja e parimeve të meritokracisë, trajtimi i korrupsionit dhe sigurimit i procedurave adekuate administrative, duke përfshirë ato sa i përket burimeve njerëzore, janë të rëndësishme bazike.

**Shoqëria civile dhe qytetarët** dhe në veçanti të rinjtë janë shpesh shumë të marginalizuar nga politika e përditshme. Dialogu në mes të vendimmarrësve dhe palëve të interesit duhet të zhvillohet më shumë. Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent i rëndësishëm i secilit sistem demokratik. Avancojnë përgjegjshmërinë politike dhe kohezionin social, duke e thelluar kuptimin dhe përfshirjen e reformave të ndërlidhura me anëtarësimin, si dhe e përkrah pajtimin e shoqërive të ndara nga konflikti. Në disa raste, duhet të zhvillohet një mjedis më mbështetës dhe që ofron mundësi që përmirëson kushtet për dialogun politik dhe të dhëna të pavarura për procesin e vendimmarrjes, të mbështetur nga statistikat e cilësisë së mirë të ofruara nga organet e pavarura statistikore. Pavarësia dhe efikasiteti i organeve kyçe siç është **avokati i popullit** dhe **institucionet shtetërore të auditimit** duhet të sigurohen dhe rekomandimet e tyre të përcjellën në mënyrë të duhur.

#### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Punoj më intensivisht me organizatat ndërkombëtare siç janë këshilli i Evropës, OSBE/ODIHR dhe OECD (SIGMA) për të mbështetur reformat elektorale dhe parlamentare; të vazhdoj të promovoj bashkëpunimin ndër-parlamentar në mes të parlamenteve kombëtare të regjionit dhe atyre të Vendeve Anëtare të BE-së dhe Parlamentit Evropian.

- Rrit prioritetin e bashkangjitur me reformën e administratës publike në procesin e anëtarësimit, me theks të veçantë mbi transparencën, de-politizimin dhe procesin e rekrutimit meritokratik.

- Rritet fokusi në shoqërinë civile, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe inkurajimin e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e sajë dhe përfshirjen më të madhe të palëve të interesit në reforma, përfshirë transparencën më të madhe të veprimeve të qeveris dhe shpenzimeve;

Promovimi i pjesëmarrjes së gjerë në procesin e pranimit, ndërtimi mbi shembullin pozitiv të Malit të zi dhe inkurajimi i transparencës maksimale në trajtimin e dokumenteve përkatëse

Në periudhën 2007-2013, mbi 30 milion € të asistencës për para-anëtarësim janë dhënë për të rritur, në mes tjerash, kapacitetin e kuvendeve kombëtare, institucionet e avokatit të popullit dhe institucionet e auditimit. Në të njëjtën periudhë, organizatat e shoqërisë civile janë përkrahur me pothuajse 190 milion € nga IPA, si dhe me mbi 35 milion € nga Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta e Njeriut (EIDHR). **Nëpërmjet IPA II**, Komisioni do të përkrah fuqizimin e institucioneve demokratike, qeverisjes së mirë, duke përfshirë avokatin e popullit, reformën e administratës publike, duke përfshirë projektet e binjakëzimit në fushat e lartpërmendura. Komisioni gjithashtu do të shqyrtojë mundësitë për të fuqizuar dhe mbështetur më tej gjeneratën e ardhshme të politik-bërësve, zyrtarëve publik dhe udhëheqësve, duke përfshirë përmes programeve më të shënjestruara të vizitave dhe një skemë të mundshme për bursa nga BE-ja. Komisioni gjithashtu do të vazhdoj të përkrah ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile, duke përfshirë Objektin e Shoqërisë Civile, dhe duke ofruar një rolë të avancuar të shoqërisë civile në programimin strategjik të IPA II.

#### **d) Të drejtat themelore**

Të drejtat civile, politike, sociale dhe ekonomike si dhe të drejtat e personave që ju takojnë minoriteteve janë çështje të rëndësishme në shumicën e vendeve në zgjerim. Të drejtat themelore janë gjerësisht të garantuara me ligj në vendet në zgjerim por në shumicën e rasteve nuk zbatohen në praktik. Më shumë duhet të bëhet për të përmirësuar pozitën e grave për të siguruar barazinë gjinore, për të zbatuar të drejtat e fëmijëve dhe për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara.

Në një numër të vendeve në zgjerim, liria e shprehjes mbetet një shqetësim serioz. Minoritetet etnike, kryesisht minoriteti Romë, përballen me shumë vështirësi, pavarësisht ekzistimit të kornizës ligjore që i mbështet të drejtat e tyre. Është e rëndësishme të konsolidohet një kornizë koherente mbi luftimin e disa formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë në fusha si media audio-vizuale, sport, politikë dhe arsim. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual po ashtu është shumë i përhapur. Këto grupe të rrezikuara gjithashtu përballen me armiqtë sociale që mund të kalojnë në gjuhë të urrejtjes, kërcënime dhe dhunë.

Në Komunikatën e këtij viti, komisioni vë theks të veçantë mbi lirinë e shprehjes, situatën e komunitetit Rom, dhe pozitën e personave të komunitetit LGBTI. Komisioni është duke punuar ngushtë, mbi këto çështje, me organizata ndërkombëtare dhe regjionale, në veçanti me Këshillin e Evropës dhe me OSBE-në. Komisioni propozon që vendet kandidatë të marrin pjesë si vëzhgues në Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore, në funksion të mbështetjes së përpjekjeve të tyre për të siguruar respekt të plot të drejtave themelore.

#### **- Liria e shprehjes**

Komisioni e ka prioritetizuar lirinë e shprehjes dhe mediave në procesin e pranimit në BE dhe në mbështetjen tonë financiare dhe teknike. Në qershor të vitit 2013, Komisioni së bashku me Parlamentin Evropian kanë mbajtur **konferencën Speak-Up!2** e cila bashkoi qindra akter nga mediat, shoqëria civile dhe autoritetet kombëtare.

Vendet në zgjerim janë karakterizuar në shumicën e vendeve nga peizazhet pluraliste të mediave. Megjithatë, konferenca Speak-Up!2 konfirmoi që një numër i sfidave të rëndësishme duhet të trajtohen urgjentisht. Rastet e **dhunës dhe kërcënimeve kundër gazetarëve** janë një problem i vazhdueshëm, duke dërguar kështu drejt vet-censurimit.

Autoritet duhet të rrisin përpjekjet e tyre në hetimin e rasteve të reja dhe të kaluara për të siguruar që sanksionet bindëse janë zbatuar kundër shkelësve. Me de-kriminalizimin e **shpifjeve**, është bërë një hap i madh drejt mbrojtjes së gazetarisë së lirë dhe kritike në Evropën jug-lindore. Megjithatë, përndjekjet e gazetarëve vazhdojnë. Ekziston nevoja për të zhvilluar dhe trajnuar gjyqësorin për të parandaluar abuzimin e fuqisë shtetërore.

Ndërhyrja politike në lirin e mediave mbetet një problem serioz. Duhet përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar pavarësinë politike dhe financiare të **shërbimit të transmetuesve publik** në Ballkanin Perëndimor. Kjo më së miri sigurohet duke pasur financim të qëndrueshëm dhe rregulla transparente për emërimin e anëtarëve të bordit dhe angazhim të fortë kombëtar për reformat e nevojshme. Në shumicën e vendeve në zgjerim, **agjencitë rregullative** nuk janë duke funksionuar në mënyrë të kënaqshme. Për më tepër, nuk ekziston **vet-rregullimi i mediave** dhe mediat duhet përpikën më shumë për të përmirësuar udhëheqjen e tyre të brendshme. Gjithashtu ekziston nevoja të trajtohet **presioni jo-formal ekonomik mbi mediat**, duke përfshirë **transparencën e pronësisë së mediave**, duke parandaluar përqendrimin e tepërt të tij dhe rregullave transparente në prokurimin e reklamimeve qeveritare. Ligjet e punës në media gjithashtu duhet të zbatohen në mënyrë të duhur.

#### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Promovoj lirinë e shprehjes dhe mediave si dhe të theksoj rëndësinë e saj për anëtarësimin në BE përmes dialogut të rregullt politik me vendet në zgjerim.
- Siguroj se liria e shprehjes dhe mediat do të trajtohen vazhdimisht si prioritet përmes kapitullit 23 të gjyqësorit dhe të drejtave themelore si dhe kapitullit 10- shoqëria informative dhe mediat.
- Japë një shpërblim për ekselencë në gazetarinë hetuese duke filluar nga viti 2014

Në periudhën 2007-2013, mbi 27 milion € janë dhënë si asistencë e para anëtarësimin për të ndihmuar vendet të adresojnë sfidat e ndërlidhura me lirinë e shprehjes. Përmes IPA II, Komisioni do të zhvilloj një vizion afatgjatë në asistencën financiare të BE-së mbi lirinë e shprehjes, gjithashtu duke punuar s`bashku me partnerët kyç (p.sh Këshilli i Evropës, OSBE, dhe OECD).

#### **- Komuniteti Rom**

Në Evropë janë rreth 10 deri 12 milionë rom, nga të cilët rreth 4 milionë prej tyre janë në Turqi si dhe 1 milion në Ballkanin Perëndimor. **Gjendja e shumicës së komuniteteve rome** nëpër Evropë është një çështje me shqetësim serioz. Shumë shpesh Romët janë viktimat e racizmit, diskriminimit dhe përjashtimit social si dhe jetojnë në varfëri të thellë, iu mungon mjaft qasja në kujdes shëndetësor, arsim dhe trajnim, strehim dhe punësim. Duke parë kushtet e vështira me të cilat ata përballen, një numër i konsiderueshëm i tyre lëshojnë rajonin dhe kërkojnë azil në një numër të vendeve të BE-së. Shumica e këtyre kërkesave janë përfundimisht të pasuksesshme. Kjo situatë është e paqëndrueshme.

Që nga viti 2011, ka hyrë në fuqi një kornizë për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve në nivel të BE-së. Qëllimet dhe parimet e kësaj kornize me fokus në reduktimin e varfërisë, përjashtimit social dhe diskriminimit të romëve, janë njësoj të rëndësishme edhe për vendet në zgjerim, ku ka nevojë më shumë të bëhet për lehtësim mbi përfshirjen sociale dhe ekonomike të romëve si dhe zhvillimi dhe siguri për zbatim adekuat, përcjellja dhe monitorimi i **strategjive kombëtare rome**. Përfshirja e Romëve duhet të bëhet një prioritet kombëtar, jo vetëm në dokumentet strategjike, por edhe në angazhim aktual në terren, me masa për rritje të qasjes në **arsim**, për të nxitur **punësimin** dhe përmirësimin e kushteve në **shëndetësi** dhe **banim**, në veçanti për të siguruar qasje në shërbime publike të tilla si uji dhe energjia elektrike. Çështjet e **dokumentacionit civil** dhe regjistrimit të romëve duhet të adresohen.

Përfshirja e Romëve mbeti një objektiv kyç dhe do të jetë një sfidë politike në rritje nëse nuk merren veprime me të vendosura. Kjo kërkon një qasje të koordinuar e bazuar në **vullnet të fortë politik** në të gjitha nivelet, veçanërisht nga **autoritetet komunale** dhe qeveritë kombëtare në vendet e prekura, si dhe ndryshimi i mentalitetit të popullatës shumicë. **Udhëheqësit Rom** po ashtu duhet të japin kontributin e tyre, duke promovuar normë më të lartë të regjistrimit civil, duke siguruar pjesëmarrje në arsimin obligativ dhe kufizimin e fluksit të azil-kërkuesve. Autoritetet lokale duhet të jenë të gatshëm të forcojnë pjesëmarrjen dhe trajtojnë rezistencën nga popullata shumicë mbi arsimin e përbashkët, përfshirë këtu edhe kushtëzimin e pagesave të mirëqenies sociale me ndjekjen e shkollës.

Komisioni është duke punuar ngushtë me të gjitha vendet në zgjerim për shqyrtimin e progresit mbi zbatimin e zotimeve kyçe të ndërmarra për të promovuar përfshirjen e mëtejshme të komunitetit Romë. Duhet të përmirësohet koherenca e mbështetjes për Romët në vendet në zgjerim me punën që po bëhet në nivel të BE-së.

### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Mbështet dhe inkurajon mbledhjet kombëtare pasuese të seminareve të vitit 2011; me monitorimin rigoroz mbi zbatimin e konkluzioneve funksionale nëpërmjet komisioneve vendore të monitorimit.
- Rrit dhe shënjestron më mirë IPA financimin përmes një 'faciliteti' rom për financimin e masave të dakorduara në seminare kombëtare, me përmirësim të bashkëpunimit me organizatat tjera ndërkombëtare.
- Mbajë një konferencë të Romëve në Bruksel në vitin 2014 mbi rrugën se si të shkohet përpara, duke përfshirë shpërblime që do t'i jepen OJQ-vë për projekte kreative dhe të suksesshme mbi përfshirjen e Romëve.

Në periudhën e viteve 2007-2013, mbi 100 milion € të asistencës së para-aderimit është ofruar për mbështetjen e përfshirjes sociale dhe integritit të romëve në vendet në zgjerim, duke përfshirë strehimin. **Nëpërmjet IPA II**, Komisioni do të shënjestroj më mirë fondet dhe fuqizoj bashkëpunimin strategjik me palët e jashtëm të interesit, identifikimin dhe ndërtimin e praktikave më të mira. Projektet që kanë drejtpërdrejt ndikim në jetën e individëve Romë do të kenë prioritet, me një fokus të veçantë në arsim dhe përfshirje sociale.

### **- Komuniteti lesbian, homoseksual, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI)**

Homofobia, diskriminimi dhe krimet nga urrejtja mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor janë ende dukuri të përhapura në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të kornizave jo të plota legjislative, por po ashtu për shkak të zbatimit kontradiktor të dispozitave ligjore në fuqi. Shkeljet e të drejtave përfshijnë diskriminimin në fusha të tilla si punësimi dhe arsimi, dështimi i disa autoriteteve për mundësuar lirinë së shprehjes dhe të tubimit, fjalimeve të urrejtjes, frikësimit dhe dhunës fizike, madje edhe vrasjeve.

Në qershor të vitit 2013, BE-ja miratoi udhëzimet për promovimin dhe mbrojtjen e gëzimit të të gjitha drejtave të njeriut nga ana e pjesëtarëve të komunitetit LGBTI që të ofrojnë udhëzime për veprimet e jashtme të BE-së në këtë fushë. Një strategji e suksesshme në këtë fushë në vendet në zgjerim kërkon angazhim të fortë politik nga ana e qeverive, autoriteteve lokale dhe organeve relevante të zbatimit të ligjit, si dhe nga BE-ja. Autoritetet e vendeve në zgjerim mund të luajë një rol kyç në sjelljen e ndryshimit të mentalitetit e gjithë shoqërisë ndaj komunitetit LGBTI, i cili shpesh në rastin më të mirë është i ndarë në dysh ndërsa në rastin më të keq është armiqësorë.

Ekziston një nevojë urgjente për zgjerimin e **legjislacionit anti-diskriminues** për të përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor brenda fushëveprimit të saj në Turqi dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. **Legjislacioni i krimit të urrejtjes** ka ende nevojë për t'u prezantuar në shumicën e vendeve. Trajnimi i zbatuesve të ligjit, institucioneve të Avokatit

të Popullit, gjykatësit dhe profesionistëve mediatik është i nevojshëm për të rritur ndërgjegjësimin mbi legjislacionin e ri, për të **siguruar zbatimin e duhur** dhe për të kontribuar në rritjen e mirëkuptimit. Vendet duhet të ndjekin një **qasje zero-tolerancë ndaj fjalimeve të urrejtjes, dhunës dhe frikësimit** dhe të marrin hapa si një çështje prioritare për të trajtuar rastet nga e kaluara dhe të jenë të përgatitur për të reaguar fuqishëm për rastet e reja në të ardhmen. Vendet duhet të marrin masa t'i **kundërvihen stereotipave dhe dezinformatave**, duke përfshirë edhe ato në sistemin arsimor. Vlerat fetare ose kulturore nuk mund të përdoren për të arsytuar çfarëdo forme të diskriminimit. Liria e tubimit dhe shprehjes duhet të mbrohet, duke përfshirë trajtimin e duhur të paradave të krenarisë, duke përfshirë edhe ato në Serbi, ku fatkeqësisht parada e këtij viti u ndalua për të tretin vit radhazi për shkaqe të sigurisë.

#### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Rritë mbështetjen politike dhe dukshmërinë nga *inter alia* duke u siguruar që këto çështje janë adresuar në mënyrë sistematike në forume të përshtatshme me vendet në zgjerim si dhe në negociatat e pranimit, vendosjen e prioriteteve më të qarta të politikave dhe përmirësimi i monitorimit dhe përcjelljes.
- Organizon një konferencë të nivelit të lartë të LGBTI-së në vitin 2014 me qëllim të analizimit të gjendjes aktuale dhe progresit të arritur, ndarjen e praktikës më të mirë, si dhe miratimin e konkluzioneve funksionale.
- Përmirëson bashkëpunimin strategjik me palët e jashtme të interesit (organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile).

Në periudhën 2007-2013, mbi 2.5 milionë € janë dhënë në mbështetje të veçantë të çështjeve të LGBTI-së, nëpërmjet të IPA-së dhe EIDHR-it. **Nëpërmjet IPA II**, Komisioni do të shënjestroj më mirë fondet, duke përfshirë trajnimin e punonjësve të institucioneve relevante publike, gjyqtarët dhe policinë, si dhe fushatat e synuara dhe iniciativat tjera (punëtori, ngjarje) për të rritur vetëdijësimin dhe tolerancën. Komisioni do të koordinojë asistencën e tij mbi këto çështje, sidomos me Këshillin e Evropës dhe OSBE-në.

#### **Ballafaqimi me çështjet bilaterale dhe tejkalimi i trashëgimisë së kaluarës**

Marrëveshja historike në muajin prill në mes të Beogradit dhe Prishtinës krijon kushte për ndërtimin e një të ardhme të përbashkët evropiane për të dyja palët. Ajo vë mosmarrëveshjet e tjera dypalëshe në një dritë të re, duke demonstruar se çfarë mund të arrihet me vullnet politik, kurajo dhe mbështetje të BE-së. Pas takimeve të shumta të nivelit të lartë të lehtësuara nga BE-ja, Serbia dhe Kosova ranë dakord me 19 prill për një 'marrëveshje të Parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve', të plotësuara në maj nga një plan i zbatimit të plotë me një afat të qartë kohor deri në fund të vitit 2013. Kjo hapi rrugën për vendimin e Këshillit Evropian për të hapur negociatat e pranimit me Serbinë dhe Këshilli të miratoj direktivat e negocimit për një MSA me Kosovën.

Gjithashtu është bërë progres në **çështjet bilaterale** në vendet tjera në rajon, me marrëdhënie të fqinjësisë së mirë - një element thelbësor i procesit të Stabilizim Asociimit –i përforcuar. Serbia dhe Bosnja e Hercegovina kanë intensifikuar kontaktet, Presidenti i Serbisë ka kërkuar falje publike për krimet e kryera në Bosnjë e Hercegovinë, dhe ka pasur një disponim të ri më konstruktiv mbi marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kroacisë. Kontaktet dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet vendeve rajonale kanë vazhduar edhe në fusha të ndjeshme si krimet e luftës, kthimi i refugjatëve, krimi i organizuar dhe bashkëpunimi policor. Janë nënshkruar disa marrëveshje në mes të prokurorëve të krimeve të luftës, duke përfshirë atë në mes të Bosnje-Hercegovinës dhe Kroacisë e Serbisë. Pengesat për ekstradim janë duke u adresuar. Përfaqësuesit e presidentëve të Bosnjës e Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës u takuan në shtator për herë të parë për të diskutuar statutin e të vërtetës dhe nismës

së pajtimit KOMRA. Ata ranë dakord mbi qëllimet dhe rolin thelbësor të kësaj nisme. Projekti rajonal i strehimit nën procesin e Sarajevës është duke u zbatuar nga Kroacia, Serbia, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi.

Progresi i bërë duhet të konsolidohet. Shumë probleme bilaterale mbeten të pazgjidhura, përfshirë këtu problemet që i përkasin minoriteteve dhe çështjeve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë siç është demarkacioni i kufirit. Pikëpamje thellësisht të kundërta të historisë së fundit i rëndojnë marrëdhëniet, ashtu siç bën përhapja e problemeve ndëretnike. Udhëheqësit politikë dhe udhëheqësit e tjerë duhet të tregojnë më shumë përgjegjësi dhe të marrin një qëndrim më të fortë që të dënojnë gjuhën e urrejtjes dhe shfaqjet e tjera të jo-tolerancës kur ato të ndodhin. Nevojitet më shumë punë që autorët e krimit të japin llogari për krimet e luftës, adresimin e çështjeve të mbetura pezull në lidhje me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit si dhe normalizimin e marrëdhënieve ndaj situatës së pakicave. Ka pasur progres të pamjaftueshëm për personat e zhdukur.

**Mosmarrëveshjet ndër-etnike dhe statusore** vazhdojnë të pengojnë funksionimin e institucioneve brenda shteteve, veçanërisht në Bosnjë e Hercegovinë, duke frustruar procesin e reformës. Çështjet e rënda etnike mund të trajtohen me sukses përmes dialogut dhe kompromisit, siç është demonstruar nga marrëveshja Serbi-Kosovë dhe zbatimi i vazhdueshëm i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Çështjet e pazgjidhura bilaterale vazhdojnë të ndikojnë negativisht në procesin e pranimit. Në frymën e marrëdhënieve të mira fqinjësore, çështjet e hapura bilaterale duhet të adresohen nga palët e interesuara sa më shpejt që të jetë e mundur. Duhet të bëhet çdo përpjekje që të shmanget bartja e mosmarrëveshjeve të rëndësishme bilaterale brenda BE-së. Komisioni i bën thirrje palëve të bëjnë çdo përpjekje drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me mjetet dhe parimet e përcaktuara, duke përfshirë dërgimin e dukur të çështjeve në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë ose organeve të tjera ekzistuese apo organeve të zgjidhjes ad hoc së mosmarrëveshjeve. Sllovenia dhe Kroacia kanë treguar që një qasje e tillë mund të dërgoj në rezultate pozitive. Çështjet bilaterale nuk duhet të mbajnë pezull procesin e pranimit.

BE-ja është tani në proces të integritit të kërkesës për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës brenda kornizës së negociatave për anëtarësim me Serbinë. Sa i përket ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, duke përfshirë edhe një zgjidhje të negociuar dhe reciprokisht të pranueshme për çështjen e emrit, nën patronazhin e OKB-së, mbetet çështje thelbësore dhe duhet të zgjidhet pa vonesë të mëtejshme. Komisioni është i gatshëm të lehtësojë krijimin e stimujve të nevojshëm politik në kërkim të zgjidhjes si dhe ti përkrah iniciativat e ngjashme.

Është thelbësor pajtimi për të promovuar stabilitetin në një rajon të prekur së fundmi nga konflikti. Vendet e rajonit, Shtetet Anëtare dhe BE-ja duhet të bëjnë më shumë për të mbështetur krijimin e një mjedisi të favorshëm në Evropën juglindore për tejkalimin e të kaluarës, në këtë mënyrë të minimizojë rrezikun e çështjeve të hapura bilaterale të instrumentalizuara politikisht. Komisioni nënvizoi rëndësinë e deklaratës të Kroacisë mbi promovimin e vlerave evropiane në Evropën Juglindore. Është për lëvdatë gatishmëria e Kroacisë për shfrytëzimin e pozicionit të saj unik si Shteti i parë Anëtar i BE-së i prekur rëndë nga konfliktet e viteve të 90-ta, që ofron mbështetje politike dhe teknike për fqinjët e saj në udhën e tyre drejt BE-së. Komisioni është i gatshëm të lehtësojë mbështetjen e tillë në veçanti përmes lehtësimit të TAIEX-it.

**Bashkëpunimi rajonal** ka vazhduar në kuadër të forumit rajonale siç është ai i Komunitetit të Energjisë, Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe Shkolla Rajonale e Administratës Publike. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal është duke zhvilluar edhe më tej rolin e tij si një platformë për promovimin e çështjeve me rëndësi për të gjithë rajonin dhe perspektiva e tij drejt BE-së kështu duke përfshirë edhe më tej bashkëpunimin rajonal në agjendat politike të shteteve.

Propozimi i Malit të Zi për një grupim të “Ballkanit Perëndimor Gjashtë” (duke sjellë së bashku Shqipërinë, Bosnjën e Hercegovinën, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë) është një nismë konstruktive, duke u bazuar në përvojën pozitive të Katërshes së Vishegradit. Është e rëndësishme që iniciativa të tilla janë plotësuese dhe shtojnë vlerë në marrëveshjet ekzistuese, dhe se ato janë me pronësi rajonale si dhe të drejtuara nga rajoni. Pjesëmarrja aktive në strategjinë makro-rajonale të Danubit dhe ai i paraparë Adriatiko-Joniane po ashtu mund të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social dhe të promovoj integrimin në BE.

### **Për të mbështetur punën në sfidat e lartpërmendura, Komisioni do të:**

- Inkurajon zhvillimin e një rrjeti të marrëveshjeve bilaterale në mes të vendeve pjesëmarrëse në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit në ofrimin e një kornize për rritjen e dialogut politik mbi çështjet kyçe.
- Vazhdon të ofroj mbështetje politike dhe lehtësime për të gjitha vendet e interesuara për të gjetur zgjidhje mbi çështjet bilaterale sa më shpejt të jetë e mundur dhe të vazhdon të mbështes në mënyrë aktive përpjekjet në forumet e tjera për të gjetur zgjidhje.

Në periudhën e viteve 2007-2013, Komisioni ka ofruar financim të konsiderueshëm të para-anëtarësimit për projektet dhe iniciativat që përkrahin pajtimin, dhe më në përgjithësi, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkuftar. **Nën IPA II**, pajtimi do të jetë një temë kyçe dhe Komisioni do të vazhdojë të përkrah iniciativat që synojnë adresimin e çështjeve të trashëguara nga lufta (procesi i Sarajevës, rrjeti i prokurorëve për krimet e luftës, procesi i të vërtetës dhe pajtueshmërisë (KOMRA)). Gjithashtu do të inkurajohet dhe përkrahet bashkëpunimi në fushat e tilla si arsimi, shkenca, kultura, media, rinia dhe sporti. Komisioni do të vazhdojë të mbështesë nismat rajonale, të tilla si Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe Shkolla Rajonale e Administratës Publike. Do të jetë e rëndësishme të sigurohet koherenca e ngushtë dhe përafrimi i fondeve në mes të programeve vendore dhe rajonale dhe strategjive relevante makro-rajonale.

\*\*\*

### **III. KONKLuzionet dhe Rekomandimet**

Bazuar në analizën e mësipërme dhe vlerësimet specifike të vendit mbi konkluzionet e vendit në aneks, Komisioni ka parashtruar **konkluzionet** dhe **rekomandimet** në vijim:

#### **I**

1. **Njëzet vite më parë** Ballkani Perëndimor ishte shkatërruar nga konflikti. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian ra dakord mbi **kriteret e Kopenhagës** për hyrjen e Vendeve të ardhshme Anëtare në BE. Dhjetë vite më vonë, në **Samitin e Selanikut të vitit 2003**, Shtetet Anëtare të BE-së u dhanë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor **një perspektivë të qartë për anëtarësim në BE**, që i nënshtrohen përmbushjes së kushteve të nevojshme, duke përfshirë edhe ato të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Kroacia ka përmbushur këto kushte, dhe në korrik të vitit 2013 BE-ja mirëpriti **Kroacinë si shtetin e 28-të anëtar**. Pranimi i Kroacisë është një shembull i fuqisë transformuese dhe efektit stabilizues të procesit të zgjerimit. Marrëveshja e arritur historike në muajin prill nga **Serbia** dhe **Kosova** është dëshmi e mëtëjshme e fuqisë së perspektivës së BE-së dhe rolit të saj në shërimin e plagëve të thella historike.

Kriteret e Kopenhagës janë po aq të rëndësishme edhe sot, duke reflektuar **vlerat**

**themelore** mbi të cilat është ngritur BE-ja: demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave themelore. **Sfidat ekonomike me të cilat përballet BE-ja** theksojnë rëndësinë e kriterëve ekonomike dhe nevojën për të konsoliduar më tej stabilitetin ekonomik dhe financiar si dhe të nxit rritjen dhe konkurrencën në vendet në zgjerim.

2. **Procesi i anëtarësimit** sot është më rigoroz dhe më i plotë sesa në të kaluarën, duke reflektuar evolucionin e politikave të BE-së, si dhe mësimet e nxjerra nga zgjerimet e mëparshme. Procesi është ndërtuar mbi **kushtëzime të rrepta por të drejta** të varura nga hapat që i merr secili vend për përmbushjen e kriterëve të vendosura për progres drejt anëtarësimit. Kjo është thelbësore për **kredibilitetin** e politikës së zgjerimit dhe për ofrimin e stimujve për vendet në zgjerim në ndjekje të reformave largpamëse. Një mësim kyç nga e kaluara është rëndësia që së pari të adresohen **çështjet themelore**.
3. **Sundimi i ligjit** është tani në zemër të procesit të zgjerimit. Qasja e re, e miratuar nga Këshilli në dhjetor të vitit 2011, nënkupton që vendet kanë nevojë ti trajtojnë në fillim të negociatave për anëtarësim çështjet e tilla si reforma gjyqësore dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo maksimizon kohën që vendet kanë për të zhvilluar një regjistër solid mbi zbatimin e reformës, duke u siguruar që reformat janë thellë të rrënjësura dhe të pakthyeshme. Kjo qasje e re është një element kyç i kornizës negociuese për Malin e Zi dhe do ti jap formë punës tonë me vendet tjera në zhvillim. Procesi i liberalizimit të vizave ka sjellë përfitime të rëndësishme për qytetarët e Ballkanit Perëndimor dhe ka stimuluar vendet për zbatim të reformave në fushën e sundimit të ligjit, si dhe kontrollit kufitar dhe migrimit. Vendet duhet ti përshpejtojnë përpjekjet për të konsoliduar reformat dhe zbatojnë masa për parandalimin e abuzimit të regjimit të liberalizimit të vizave.
4. Kriza globale ekonomike ka nënvizuar nevojën për të gjitha vendet ta forcojnë **qeverisjen e tyre ekonomike**. Asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk ka një ekonomi funksionale të tregut. Të gjitha shtetet janë të prekura nga papunësia e lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve. Është thelbësore që këto vende ti intensifikojnë reformat për të arritur një rritje të qëndrueshme dhe të adresojnë sfidat e nevojshme për ti përmbushur kriteret ekonomike dhe të përmirësojnë **konkurrencën**. Komisioni ka përcaktuar një numër propozimesh për të mbështetur këtë synim, duke përfshirë futjen e strategjive kombëtare të reformave ekonomike dhe planeve të veprimit për menaxhimin e financave publike. Komisioni do të punojë me institucionet kryesore financiare ndërkombëtare për ti mbështetur reformat që çojnë në përmbushjen e kriterëve ekonomike. Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë ti përkrahë investimet që nxisin krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Është i rëndësishëm krijimi i një mjedisi më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta.
5. Ngjarjet në një numër të vendeve në zgjerim kanë nënvizuar rëndësinë e **forcimit të institucioneve demokratike** dhe duke u siguruar që proceset demokratike janë më përfshirëse. Komisioni inkurajon dhe do të mbështesë nëpërmjet asistencës së tij financiare një rol më të fuqishëm të shoqërisë civile dhe platformave ndërpartiake për integrim në BE. Komisioni gjithashtu do ti promovojë reformat zgjedhore, parlamentare dhe ato të administratës publike, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat tjera ndërkombëtare në këto fusha.
6. Bashkimi Evropian është themeluar mbi vlerat dhe parimet e përbashkëta, duke përfshirë respektimin për të **drejtat themelore**. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe Turqia duhet të ndërmarrin reforma të mëtejshme për tu siguruar që parimet e lirisë së shprehjes dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, duke përfshirë këtu edhe **Romët** të respektohen në praktikë. Janë të nevojshme masa më të fuqishme për ti mbrojtur **grupet e tjera të rrezikuara** nga diskriminimi, në veçanti në baza të orientimit seksual. Komisioni do të rrit prioritetin që lidhet me këto çështje në procesin e anëtarësimit, duke përfshirë shënjestrim më të mirë të financimit të IPA-s



dhe asistencën e rritur për përkrahje mbi përfshirjen e Romëve përmes një 'lehtësimit' për komunitetin rom.

7. **Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** janë elemente thelbësore të procesit të Stabilizimit Asociimit. Çështjet që lidhen me konfliktet e të kaluarës, duke përfshirë krimet e luftës dhe kthimin e refugjatëve, si dhe trajtimi i pakicave dhe sigurimi i të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët mbeten sfida kyçe për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe kanë nevojë të trajtohen plotësisht. Për këtë qëllim, Komisioni do të vazhdojë të mbështesë iniciativat që synojnë tejkalimin e të kaluarës. Bashkëpunimi rajonal duhet të forcohet më tej, të jetë gjithëpërfshirës dhe me pronësi rajonale. Komisioni mbështet plotësisht punën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp) dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, duke përfshirë këtu edhe strategjinë Rajonale 2020.
8. Është e nevojshme një përpjekje e përtërirë për t'i tejkeluar **mosmarrëveshjet bilaterale** midis vendeve në zgjerim dhe Shteteve Anëtare ekzistuese. Çështjet bilaterale duhet të trajtohen nga palët e interesuara sa më shpejt të jetë e mundur dhe nuk duhet të mbajnë pezull procesin e pranimit. Komisioni u bën thirrje palëve të bëjnë çdo përpjekje drejt zgjidhjes së kontesteve të pazgjidhura në përputhje me parimet dhe mjetet e përcaktuara. Konteksti i negociatave për anëtarësim mund të gjeneroj një nxitje politike për zgjidhje të mosmarrëveshjeve. Komisioni do të vazhdojë të ofrojë mbështetje politike dhe lehtësim për të gjitha vendet e interesuara për të gjetur zgjidhje për çështjet dypalëshe sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive përpjekjet në forumet e tjera për të gjetur zgjidhje. Komisioni do të inkurajojë zhvillimin e një rrjeti të marrëveshjeve bilaterale mes vendeve palë në Marrëveshjet e Stabilizimit Asociimit që të ofrojë një kornizë për rritjen e dialogut politik mbi çështjet kyçe.
9. Viti 2014 parasheh nisjen e **Instrumentit të dytë për Ndihmën e Para-Anëtarësimit** për periudhën deri në vitin 2020. Nëpërmjet IPA II, BE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të konsiderueshme vendeve në zgjerim mbi përgatitjet e tyre për anëtarësim dhe gjithashtu do të mbështesë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkuftar. Fokusi do të jetë në fushat e interesit të përbashkët me më pak prioritete si dhe me projekte më të mëdha. Sfidat kyçe me të cilat përballen vendet do të trajtohen në një mënyrë më strategjike dhe koherente, me inovacione duke përfshirë një qasje sektoriale, stimuj për performancë më të mirë, mbështetje e rritur për buxhetin dhe një fokus më i fuqishëm për arritje të rezultateve të matshme. Komisioni do të forcoj bashkëpunimin me INF-të ashtu që fondet e IPA-së do të mund t'i ofrojnë përfitime kapitalit privat përmes instrumenteve inovative financiare, si ndihmesë mbi përmbushjen e nevojave të larta për investime dhe krijim të rritjes dhe punësimit.
10. Politika e zgjerimit varet nga mbështetja e qytetarëve të BE-së. Kjo është esenciale për Shtetet Anëtare, së bashku me institucionet e BE-së, për të udhëhequr një debat të informimit mbi ndikimin politik, ekonomik dhe social të politikës së zgjerimit. Ata kanë një rol kyç në ofrimin e fakteve për qytetarët mbi politikën e zgjerimit dhe duke vepruar kështu, t'i informojnë ata për përfitimet, duke përfshirë edhe kontributin madhor për paqe, sigurinë dhe mirëqenien si dhe të adresojnë ndonjë shqetësim që ata mund të kenë.

## II

11. **Mali i Zi:** Nisja e negociatave për anëtarësim në vitin e kaluar ka shënuar hapjen e një faze të re për Malin e Zi në rrugën e tij drejt BE-së. Reformat e thella dhe të qëndrueshme politike të nevojshme për të zbatuar qasjen e re ndaj kapitullit 23 mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore si dhe kapitullin 24 mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, do të kërkojë vullnet të fortë politik dhe kapacitet administrativ të zgjeruar. Procesi i anëtarësimit duhet të jetë gjithëpërfshirës, me përfshirje të fuqishme nga

shoqëria civile. Mali i Zi ka miratuar plane të detajuara të veprimt dhe ka ofruar një agjendë të gjithanshme të reformave për forcimin e sundimit të ligjit. Zbatimi i këtyre planeve dhe progresi në përmbushjen e standardeve të përkohshme mbi këta kapituj do të përcakton ritmin e përgjithshëm të negociatave për anëtarësim. Në këtë drejtim, janë thelbësore zbatimet e ndryshimeve kushtetuese të muajit korrik të cilat fuqizojnë pavarësinë e gjyqësorit dhe sigurojnë progres të mëtejshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë edhe ato të nivelit të lartë.

Reforma e administratës publike është një prioritet, për t'u siguruar që Mali i Zi ka kapacitet për ta zbatuar *acquis-in*, për ta trajtuar politizimin dhe rrisë transparencën dhe profesionalizmin e shërbimit civil. Ngjarjet që kanë ndodhur gjatë muajve të fundit, në veçanti shfrytëzimi i pretenduar i fondeve publike për qëllime të partive politike, kanë theksuar rëndësinë për forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike. Në këtë kontekst, është e rëndësishme për tu siguruar që hetimet kanë përfunduar tërësisht dhe me shpejtësi, dhe se është marrë çdo veprim i duhur. Gjithashtu është e nevojshme përcjellja adekuate e punës së grupit parlamentar gjatë procesit zgjedhor. Duhet të fuqizohet liria e shprehjes, duke përfshirë këtu hetimin e duhur për të gjitha rastet e dhunës dhe kërcënimeve kundër gazetarëve dhe sjelljen e autorëve të krimit para drejtësisë. Në fushën ekonomike, përmirësimi i mjedisit biznesor dhe trajtimi i papunësisë së lartë janë çështje kyçe. Tani është urgjent ristrukturimi i prodhuesit të aluminit KAP.

12. **Serbia:** Viti 2013 ka qenë një vit historik për Serbinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Vendimi i Këshillit Evropian në muajin qershor për të hapur negociatat e pranimit paraqet fillimin e një faze të re të rëndësishme në marrëdhëniet mes Serbisë dhe Bashkimit Evropian. Ky është një vlerësim për progresin e bërë mbi reformat kyçe si dhe përpjekjet e konsiderueshme të bëra nga Serbia drejt normalizimit të marrëdhënieve të saj me Kosovën. Në muajin shtator ka hyrë në fuqi, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Serbia ka punuar në mënyrë aktive dhe konstruktive drejt një përmirësimi të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Kosovën. Në muajin prill, angazhimi i Serbisë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja rezultoi në "Marrëveshjen e parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve" (Marrëveshja e Parë) me Kosovën, e cila u plotësua në muajin maj nga një plan zbatues. Zbatimi ka vazhduar dhe tashmë ka dërguar drejt një numri të ndryshimeve të pakthyeshme në terren. Palët gjithashtu arritën marrëveshje mbi energjinë dhe telekomunikacionin. Serbia duhet të mbes plotësisht e angazhuar për normalizim të vazhdueshëm të marrëdhënieve me Kosovën si dhe të zbatoj të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog.

Komisioni ka filluar me monitorimin e *acquis-it* në muajin shtator dhe mirëpret konferencën e parë ndër-qeveritare mbi pranimin e Serbisë më së fundi deri në janar të vitit 2014, pasi që Këshilli të miratoj kornizën e negociatave. Në këtë fazë të re kërkuese, Serbia do të duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë fushave kyçe të sundimit të ligjit, veçanërisht zbatimin e reformës së gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformës së administratës publike, pavarësisë së institucioneve kyçe, lirinë e medias, mos-diskriminimi dhe mbrojtja e minoriteteve. Strategjia për komunitetin Rom duhet të zbatohet në mënyrë proaktive. Serbia duhet të vazhdojë përmirësimin e mjedisit afarist si dhe të zhvillojë një sektor privat konkurrues. Trajtimi i papunësisë së lartë është po ashtu thelbësor. Serbia ka nevojë të ndërtoj në kontributin e saj pozitiv të bërë gjatë vitit të kaluar për bashkëpunimin rajonal, i cili përfshinte rritjen e nivelit të lartë kontaktues me vendet fqinje.

13. **Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë:** Kriza politike që pasoi ngjarjet në parlament vitin e kaluar ka ekspozuar ndarjet e thella në mes të partive politike, që ndikojnë në funksionimin e parlamentit, dhe ka demonstruar nevojën për politika

konstruktive në interes kombëtar. Vazhdimi i zbatimit të marrëveshjes politike të 1 marsit është thelbësor. Agjenda e BE-së mbetet prioritet strategjik i vendit. Dialogu i Nivelit të Lartë për Anëtarësim ka kontribuar në progres në shumë fusha me prioritet, duke përfshirë eliminimin e lëndëve të mbetura gjyqësore si dhe progresin në luftën kundër korrupsionit. Vendi ka arritur tashmë në një nivel të lartë të përafrimit mbi atë se ku ndodhet ajo në procesin e anëtarësimit si dhe ka bërë përparim të mëtijshëm në përmirësim të aftësisë së saj për ti marrë përsipër detyrimet e procesit të anëtarësimit.

Prioriteti i reformave për vitin e ardhshëm duhet të jetë zbatimi dhe fuqizimi efektiv i kornizave dhe politikave ekzistuese ligjore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sundimit të ligjit, përfshirë këtu pavarësinë e gjyqësorit si dhe arritjes së rezultateve të mëtijshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Situata e lirisë së shprehjes dhe medias në përgjithësi mbetet ende një çështje shqetësuese. Shqyrtimi i *Marrëveshjes Kornizë të Ohrit*, veçanërisht e rëndësishme për marrëdhëniet ndëretnike, duhet të përfundohet dhe rekomandimet e saj të zbatohen. Strategjia për komunitetin rom duhet të zbatohet në mënyrë proaktive. Duhet të trajtohen paqartësitë e dallimit në mes të shtetit dhe partisë, siç është theksuar nga OSBE / ODIHR-it në kontekstin zgjedhor. Papunësia e lartë duhet të trajtohet dhe menaxhimi publik financiar duhet të forcohet.

Komisioni konsideron se kriteri politik vazhdon të përmbushet mjaftueshëm dhe rekomandon që të hapen negociatat e pranimit. Kalimi në fazat e ardhshme më sfiduese të procesit të zgjerimit është esencial në mënyrë që të konsolidohen dhe inkurajohen reforma të mëtijshme, si dhe ti fuqizoj marrëdhëniet ndër-etnike. Dialogu i Nivelit të Lartë për Anëtarësim është një mjet i dobishëm i cili do të vazhdon të fokusohet në çështjet kyçe, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, por nuk mund ti zëvendësojë negociatat e pranimit.

Komisioni mbetet i bindur që vendimi për ti hapur bisedimet e pranimit do të kontribuojë në krijimin e kushteve të favorshme për përmirësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore në përgjithësi dhe, në veçanti, për të gjetur një zgjidhje të pranueshme nga dy palët për çështjen e emrit, çështje kjo që Komisioni e konsideron thelbësore. Pas gati dy dekadave të angazhimit intensiv politik nga të gjitha palët në procesin e OKB-së është e nevojshme që më në fund të arrihet një zgjidhje, me angazhim aktiv të komunitetit ndërkombëtar.

Kjo është hera e pestë që Komisioni rekomandon hapjen e negociatave për anëtarësim me këtë vend. Asnjë vendim nuk është marrë nga Këshilli deri më sot. Dështimi për të vepruar mbi këtë rekomandim paraqet sfida potencialisht serioze për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe BE-së. Kjo vë në pikëpyetje kredibilitetin e procesit të zgjerimit, i cili është i bazuar në kushtëzim të qartë dhe parime të meritave të saj. Mungesa e një perspektive të besueshme të BE-së vë në rrezik qëndrueshmërinë e përpjekjeve të vendit për reformë.

Pas ftesës nga Këshilli Evropian, Komisioni përsërit synimin e tij që të prezantoje pa vonese një propozim për një kornizë të negociatave, e cila merr parasysh nevojën për zgjidhjen e çështjes së emrit në një fazë të hershme të negociatave për pranimit, dhe do të vazhdoj procesin e ekzaminimit analitik të *acquis-it* të BE-së duke filluar me kapitujt në gjyqësor dhe të drejtat themelore, si dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Komisioni konsideron që, nëse monitorimi dhe diskutimi i këshillit mbi kornizën e negociatave janë në proces e sipër, mund të krijohet vrulli i nevojshëm që do të përkrah gjetjen e negociueshme dhe të pranueshme të zgjidhjes së çështjes së emrit nga të dyja palët edhe para se të hapen negociatat për kapitujt. Zbatimi i përafrimit të ri mbi kapitujt 23 dhe 24 po ashtu për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të ofronte mjetet e nevojshme për trajtimin e çështjeve kyçe me rendësi edhe për Shtetet Anëtare dhe ti kontribuojë qëndrueshmërisë së reformave

Përpara përvjetorit të dhjete të hyrjes në fuqi të MSA-së në prill të vitit 2004, Komisioni gjithashtu bën thirrje për here të peste në Këshill që të miratoj propozimin e vitit 2009 për kalim në fazën e dytë të asociimit, në përputhje me dispozitat relevante të MSA-së e cila parasheh që asociimi do të kryhet përfundimisht gjatë një periudhe kalimtare prej maksimum dhjetë vitesh.

14. **Shqipëria** Gjatë tetorit të vitit të kaluar, Komisioni ka rekomanduar që Këshilli duhet t'i ofrojë Shqipërisë statusin e vendit kandidat me kusht që të përfundojnë masat kyçe në fushat e gjyqësorit, reformës në administratën publike, si dhe shqyrtimi i rregullores së punës parlamentare. Në dhjetor të vitit 2012, me synimin për të vendosur se a do të jepet statusi kandidat apo jo, Këshilli ka ftuar Komisionin të raportojë posa të arrihet progresi i duhur, po ashtu duke marrë parasysh veprimet shtesë të ndërmarrë nga Shqipëria në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen pro-aktive të këtyre rasteve. Në këtë aspekt, Shqipëria ka miratuar pjesën e mbetur të reformave në gjyqësor, administratë publike dhe parlament me konsensus ndër-partiak. Zgjedhjet parlamentare në muajin qershor ishin vlerësuar nga misioni ndërkombëtar mbikëqyrës për zgjedhje të udhëhequr nga OSBE/ODIHR-i si konkurrese me pjesëmarrje aktive të qytetarëve nëpër fushata si dhe respektim i sigurtë për liritë themelore. Në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Shqipëria ka ndërmarrë hapa fillestar drejt përmirësimit të efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjeve penale si dhe forcimit të bashkëpunimit në mes të organeve të zbatimit të ligjit. Numri i dënimeve për korrupsion dhe pastrim parash është rritur, sikurse numri i hetimeve për trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogës. Janë adresuar në mënyrë të suksesshme të gjitha rekomandimet e fundit të Këshillit Evropian në lidhje me financimin e partive politike dhe dispozitave ligjore mbi korrupsionin. Qeveria e re e Shqipërisë ka bërë një angazhim të fuqishëm në luftën kundër korrupsionit dhe i ka dhënë prioritet kësaj çështje në programin e saj.

Në pikëpamje të arritjes së progresit të nevojshëm nga Shqipëria, Komisioni rekomandon që Këshilli duhet t'i jep Shqipërisë statusin e vendit kandidat në kuptim që Shqipëria të vazhdojë të ndërmerr masa në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Përtej mendimit të Komisionit për vitin 2000, Shqipëria duhet të plotësojë prioritetet kyçe të mëposhtme për hapjen e negociatave për praninë:

1. Vazhdon të zbatohet reformën e administratës publike me synim të përmirësimit profesionalizimit dhe depolitizimit të administratës publike;
2. Të ndërmarrë veprime për përfundimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së institucioneve gjyqësore;
3. Të bëjë përpjekje të caktuara shtesë në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë krijimin e një regjistri solid të hetimeve pro-aktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve;
4. Të bëjë përpjekje të caktuara shtesë në luftën kundër krimin të organizuar, duke përfshirë krijimin e një regjistri solid të hetimeve pro-aktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve;
5. Të ndërmarr masa efektive për fuqizimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë komunitetin Rom, politikën anti-diskriminuese si dhe zbatimin e të drejtës pronësore.

Komisioni qëndron i gatshëm të përkrah përpjekjet e Shqipërisë drejt përmirësimit të këtyre prioritetëve kyçe duke u angazhuar në një dialog të nivelit të lartë me vendin.

Dialogu konstruktiv dhe i qëndrueshëm në mes të qeverisë dhe opozitës në lidhje me

reformat e BE-së do të jete vital në sigurimin e të ardhmes së Shqipërisë në BE. Angazhimi konstruktiv i Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal mbetet thelbësor

15. **Bosnja dhe Hercegovina** është në një situatë të shtanguar për sa i përket integriteteve evropiane. Vendi ka nevojë të zbatohet pa vonesa të mëtejshme vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut për rastin Sejdiç-Fincin në mënyrë që të ece përpara në rrugën drejt BE-së. Adresimi i këtij gjykimi nuk është kritik vetëm për vendin të avancuar në rrugën drejt BE-së, por gjithashtu edhe për legjitimitetin dhe besueshmërinë e Presidencës dhe Dhomës së Popujve të Bosnjë e Hercegovinës të cilët duhet të zgjidhen në vitin 2014. Bosnja e Hercegovina gjithashtu ka nevojë të krijojë urgjentisht një mekanizëm koordinues për çështjet e BE-së në mënyrë që ajo të mund të flas me një zë për agjendën e BE-së.

Ekziston rreziku që asistencën e para-anëtarësimit nuk do t'i prodhojë rezultatet e pritura pa konsensusin e nevojshëm për të ecur përpara në rrugën drejt BE-së. Duke pasur parasysh se ende nuk është gjetur asnjë zgjidhje mbi zbatimin e aktvendimit për rastin Sejdiç-Finci si dhe mos-themelimi i mekanizmit të koordinimit të BE-së, nuk mund të mbahet niveli i njëjtë i fondeve të para-anëtarësimit të BE-së.

Komisioni ka vendosur të shtyjë diskutimet e mëtejshme mbi IPA II derisa vendi të kthehet në rrugën e duhur të procesit integruar në BE. Bosnja dhe Hercegovina rrezikon humbje të fondeve të IPA-s në mungesë të progresit të prekshëm.

BE-ja është e angazhuar fuqishëm për të mbështetur Bosnjën dhe Hercegovinën dhe qytetarët e saj për të përmbushur shpresat dhe ambiciet e tyre për të bërë progres në rrugën drejt BE. Përparimi i mëtejshëm varet nga aftësia e udhëheqësve politikë që të punojnë së bashku dhe të bien dakord mbi një kompromis që hap rrugën për në BE. Arritja e një kompromisi të tillë do të ndihmojë rikthimin e besimit të qytetarëve në kapacitetin e liderit për të bërë integritetin në BE. Kjo do të hapë rrugën për hyrje në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe më pas një aplikim i besueshëm për anëtarësim.

Derisa ka pasur progres të kufizuar në reforma të përgjithshme të sistemit gjyqësor, një numër i rekomandimeve të lëshuara nga Komisioni në kuadër të Dialogut të Strukturuar mbi Drejtësi janë duke u zbatuar. Ky dialog tregon potencialin e agjendës së zgjerimit si dhe përfitimet e angazhimit efektiv. Disa përparime janë bërë po ashtu edhe në zvogëlimin e numrit të lëndëve të mbetura të krimeve të luftës. Përgatitjet e plota në të gjitha nivelet, të mbështetura nga BE-ja dhe organizatat tjera ndërkombëtare, gjithashtu e kanë bërë të mundur që të kryhet regjistrimi i shumëpritur. Megjithatë vendi ballafaqohet me sfida të mëdha. Duhet vëmendje e shtuar për sundimin e ligjit, duke përfshirë reformën gjyqësore dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, reformën e administratës publike, lirinë e shprehjes, adresimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe trajtimin e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin ndaj romëve. Reformat të mëtejshme ekonomike janë të nevojshme për të përmirësuar mjedisin e dobët biznesor dhe për të krijuar një hapësirë unike ekonomike në vend.

Pas pranimit të Kroacisë, Komisioni konstaton se është e papranueshme që Bosnja dhe Hercegovina deri më sot ka refuzuar të përshtat Marrëveshjen e Përkohshme/Stabilizimit-Asociimit duke marrë parasysh tregtinë e saj tradicionale me Kroacinë. Komisioni i bën thirrje Bosnjë dhe Hercegovinës që të rishikojë urgjentisht pozicionin e saj në mënyrë që të finalizohet sa më shpejt të jetë e mundur një adaptim në bazë të rrjedhave tradicionale të tregtisë.

**16. Kosova:** Viti 2013 ka qenë një vit historik për Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian.

Vendimet e Këshillit në qershor autorizuan hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociim (MSA), e cila paraqet fillimin e një faze të re të rëndësishme në marrëdhëniet BE-Kosovë. Ky është një vlerësim për progresin e bërë në reformat kyçe dhe përpjekjet e konsiderueshme të bëra nga Kosova drejt normalizimit të marrëdhënieve të saj me Serbinë. Negociatat mbi marrëveshjen priten të hapen zyrtarisht këtë muaj. Komisioni ka për qëllim që të përfundojë këto negociata në pranverë të vitit 2014, për të filluar draft-marrëveshjen në verë dhe më pas t'i dorëzojë propozimet për Këshillin që të nënshkruaj dhe të përfundojë Marrëveshjen.

Kosova ka punuar në mënyrë aktive dhe konstruktive drejt një përmirësimi të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë. Në prill, angazhimi i Kosovës në dialogun e lehtësuar të BE-së rezultoi me 'Marrëveshjen e parë të parimeve që qeveris normalizimin e marrëdhënieve' me Serbinë (Marrëveshja e parë), e cila u plotësua në muajin maj nga një plan i zbatimit. Zbatimi ka vazhduar dhe tashmë ka çuar në një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren. Palët gjithashtu arritën marrëveshje për sa i përket energjisë dhe telekomunikacionit. Kosova duhet të mbetet e angazhuar plotësisht në normalizimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog. Komisioni do të sigurojë fonde shtesë nga IPA për të ndihmuar në zbatimin e marrëveshjes së muajit prill për komunitetet në fjalë.

Sundimi i ligjit vazhdon të jetë një prioritet kyç për Kosovën. Ai është gjithashtu një gur-themel i Procesit të Stabilizim Asociimit në të cilën bënë pjesë Kosova. Dialogu i strukturuar mbi sundimin e ligjit do të vazhdojë të mbështesë dhe të udhëzon Kosovën në këtë fushë, duke përfshirë edhe diskutimet mbi të ardhmen e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit- EULEX. Kosova vazhdon të marrë masa për të adresuar prioritetet e përcaktuara në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave dhe Komisioni do të raportojë në gjysmën e parë të vitit 2014.

Kosova tani duhet të përqendrohet në zbatimin e reformave që të përmbushë detyrimet e saj në kuadër të MSA-së së ardhshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajtimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndjekja e reformave në gjyqësorë dhe administratë publike, duke siguruar të drejtat e personave që u përkasin pakicave - përfshirë këtu edhe komunitetin Rom - si dhe adresimi i çështjeve tregtare. Kosova ka nevojë për të trajtoj urgjentisht papunësinë dhe dobësitë strukturore që ndikojnë në tregun e saj të punës.

Komisioni gjithashtu u bën thirrje të gjithë personave me të drejtë vote që të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme komunale në nëntor të këtij viti. Kjo është një mundësi e rëndësishme për komunitetin lokal në veri të Kosovës që të mbrojë të drejtat e tij demokratike dhe të luaj një rol të plotë në zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Komisioni pret që autoritetet të sigurojnë se zgjedhjet do të jenë gjithëpërfshirëse dhe që do të respektojnë plotësisht parimet demokratike.

**17. Turqia** është një vend kandidat dhe një partner strategjik për Bashkimin Evropian. Turqia, me ekonominë e saj të gjerë, dinamike, është një partner i rëndësishëm tregtar për BE-në dhe një komponent i vlefshëm i konkurrencës së BE-së përmes bashkimit doganor. Turqia ka një lokacion strategjik, duke përfshirë sigurinë e energjisë, si dhe luan një rol të rëndësishëm regjional. Komisioni thekson rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe rëndësinë e dialogut për çështjet e politikës së jashtme. Agjenda pozitive, e nisur në vitin 2012, vazhdon të mbështesë dhe plotësojë negociatat e anëtarësimit me Turqinë, por nuk është një zëvendësim për negociatat. Potenciali i plotë i marrëdhënieve BE-Turqi është plotësuar më së miri në kuadër të një procesi aktiv dhe të besueshëm të anëtarësimit, ku BE-ja mbetet spirancë për reformat ekonomike dhe politike të Turqisë. Më shumë kontakte të nivelit të lartë ndërmjet Turqisë, BE-së dhe Shteteve të saj Anëtare do të

forconin më tej bashkëpunimin.

Progres i rëndësishëm mbi reformat është bërë gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Pakoja e katërt e reformës gjyqësore forcon mbrojtjen e të drejtave themelore, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe luftën kundër mosndëshkimit për rastet e torturës dhe keqtrajtimit. Qeveria ka filluar një proces historik paqeje që synon fundin e terrorizmit dhe dhunës në juglindje të vendit duke hapur rrugën zgjidhjes së çështjes së kurdëve. Masat e shpallura në paketën e demokratizimit të paraqitura në shtator të vitit 2013 parashikojnë reforma të mëtejshme për një sërë çështjesh të rëndësishme, duke përfshirë edhe përdorimin e gjuhëve të tjera përveç asaj turke, të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe adresimin e pragjeve të larta aktuale për përfaqësim në parlament dhe mbështetje buxhetore për partitë politike. Zbatimi në bashkëpunim me palët e interesit dhe në përputhje me standardet evropiane është çelësi. Komiteti pajtues ndërpartiak i parlamentit, i cili u ngrit për të hartuar një kushtetutë të re, ka arritur marrëveshje mbi një numër të neneve. Me miratimin e një ligji gjithëpërfshirës për të huajt dhe mbrojtjen ndërkombëtare, një hap i rëndësishëm është ndërmarrë në drejtim të mbrojtjes adekuate të azilkërkuësve. Institucioni i Avokatit të Popullit është krijuar dhe tashmë është duke punuar në mënyrë aktive për të përmbushur rolin e tij. Debati publik mbi temat e konsideruara më parë si të ndjeshme është rritur. Turqia i ka dhënë gjithashtu ndihmë vitale humanitare një numri të madh të Sirianëve që po largoheshin nga vendi i tyre. Zhvillime të tjera pozitive përfshijnë ratifikimin nga Turqia të Marrëveshjes për tubacionin Trans-Anatolian që ka për qëllim lidhjen me Tubacionin Trans-Adriatik, për të sjellë gazin natyror në BE nga Deti Kaspik nëpërmjet Turqisë.

Përdorimi i tepruar i forcës nga policia dhe mungesa e përgjithshme e dialogut gjatë protestave në muajt maj / qershor kanë ngritur shqetësime serioze. Kjo thekson nevojën urgjente për reforma të mëtejshme dhe nxitjen e dialogut nëpër të gjithë spektrin politik dhe në shoqërinë në përgjithësi, si dhe respektimin e të drejtave themelore në praktikë. Një numër i hetimeve administrative dhe gjyqësore janë nisur sa i përket sjelljes së policisë gjatë protestave. Këto duhet të ndiqen në përputhje me standardet evropiane dhe ata që janë përgjegjës të japin përgjegjësi. Ministria e Brendshme ka nxjerrë dy qarkore që synojnë përmirësimin e procedurave për ndërhyrjen e policisë gjatë demonstratave. Është e rëndësishme që të vazhdohet me planet për krijimin e një mekanizmi monitorues për zbatimin e ligjit në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen e pavarur të sjelljes së policisë. Ndryshime të mëtejshme janë të nevojshme edhe në sistemin ligjor turk, në veçanti për të forcuar lirinë e shprehjes dhe të mediave dhe lirinë e tubimit dhe tubimit; praktika gjyqësore duhet sistematikisht të reflektojë standardet evropiane. Pakoja e katërt e reformës gjyqësore duhet të zbatohet në mënyrë të plotë. Vala e protestave në muajin qershor është edhe rezultat i reformës së gjerë demokratike, që ka ndodhur në dekadën e kaluar dhe shfaqjes së një shoqërie civile të gjallë dhe të larmishme që duhet të respektohet dhe të konsultohet në mënyrë më sistematike në çdo nivel të vendimmarrjes, pavarësisht se kush posedon shumicën në parlament.

Të gjitha këto zhvillime theksojnë rëndësinë e angazhimit të BE-së dhe që BE-ja të mbetet një pikë e referimit për reformën në Turqi. Për këtë arsye, negociatat e anëtarësimit duhet rimarrin vrullin, duke respektuar angazhimet e BE-së dhe kushtëzimet e vendosura. Në këtë drejtim, hapja e kapitullit të 22 në politikën rajonale përfaqëson një hap të rëndësishëm, Komisioni mirëpret mbajtjen sa më parë të KNQ-së . Turqia ka bërë progres në një numër të kapitujve të tjerë. Turqia mund të përshpejtojë ritmin e negociatave me anë të përmbushjes së standardeve, përmbushjen e kërkesave të kuadrit negociues dhe duke respektuar detyrimet kontraktuale të saj drejt BE-së.

Progresi në negociatat e anëtarësimit dhe progresi në reformat politike në Turqi janë dy anë të së njëjtës medalje. Është në interes të të dyjave Turqisë dhe BE-së që pikat hyrëse për Kapitullin 23: Të Drejtat Themelore dhe Gjyqësori dhe për Kapitullin 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria të bien dakord dhe të komunikohen në Turqi sa më shpejt të jetë e

mundur me synimin për të mundësuar hapjen e negociatave nën këto dy kapituj në mënyrë që të rrisin dialogun e BE-së me Turqinë në fushat me interes vital të ndërsjellë dhe për të mbështetur përpjekjet e vazhdueshme për reforma. Nënshkrimi i marrëveshjes së ri-pranimit Turqi-BE dhe fillimi i njëkohshëm i dialogut të vizave drejt liberalizimit të vizave do të japë një vrull të ri në marrëdhëniet BE-Turqi dhe do të sjellë përfitime konkrete për të dyja. Është e rëndësishme që këto dy procese të ecin përpara dhe se nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes së ri-pranimit në Turqi të finalizohet me shpejtësi. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit energjetik BE-Turqi dhe progresi në negociatat e anëtarësimit do të lehtësojë ndërlidhjen dhe integrimin e tregjeve të energjisë së BE-së dhe Turqisë.

Komisioni thekson gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së të cilat përfshijnë ndër të tjera, hyrjen në marrëveshjen dypalëshe, si dhe për të eksploruar dhe shfrytëzuar burimet e tyre natyrore në përputhje me *acquis-in e* BE-së dhe ligjin ndërkombëtar, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit. Në përputhje me pozitat e përsëritura të Këshillit dhe Komisionit nga vitet e kaluara, tani është urgjente që Turqia të përmbushë detyrimin e vet, të zbatojë plotësisht protokollin shtesë dhe të bëjë progresin drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Kjo mund të japë një hov të ri në procesin e anëtarësimit, duke lejuar në veçanti të bëhet progres në tetë kapitujt të mbuluar nga konkludimet e Këshillit të muajit dhjetor 2006. Komisioni gjithashtu kërkon shmangien e çfarëdo lloj kërcënimi, burimi të grindjeve apo veprim që mund të dëmtojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Angazhimi dhe kontributi i Turqisë në kushte konkrete për një zgjidhje gjithëpërfshirëse për çështjen e Qipros është vendimtar.

18. Sa i përket **çështjes së Qipros**, Komisioni pret që komunitetet qipriotë grek dhe qipriotë turk të rifillojnë negociatat e barabarta mbi një zgjidhje gjithëpërfshirëse nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara. Komisioni pret që të dyja palët të lëvizin me shpejtësi drejt thelbit me qëllim të arritjes së shpejtë të një përfundimi të suksesshëm. Të gjitha palët janë të inkurajuar për të kontribuar në krijimin e një klime pozitive ndërmjet komuniteteve, nëpërmjet hapave që qipriotët përfitojnë në jetën e tyre të përditshme, dhe për ta përgatitur publikun për kompromiset e nevojshme. Komisioni është i mendimit që përfitimet e ribashkimit do të peshojnë më shumë sesa ndonjë koncesion tjetër që do të duhet të bëhet për të arritur këtë qëllim. Në veçanti, të gjithë qipriotët plotësisht do të përfitojnë nga shfrytëzimi i burimeve të hidro-karbonit. Komisioni është i gatshëm për të forcuar edhe më tej mbështetjen e tij për procesin, në rast që dy palët e kërkojnë atë dhe OKB-ja të pajtohet.
19. **Islanda:** Islanda ka arritur një fazë të avancuar të negociatave për anëtarësim, kur qeveria e re vendosi për të vënë negociatat në pritje, dhe procesi i anëtarësimit ka ardhur deri në një ndalesë. Qeveria deklaroi se do të ndërmarrë një vlerësim të negociatave të deritashme, si dhe mbi zhvillimet në Bashkimin Evropian, e cila do t'i dorëzohet parlamentit islandez për diskutim në muajt e ardhshëm. Komisioni ka pezulluar punën përgatitore për IPA II. Sipas të gjitha rrethanave, Islanda mbetet një partner i rëndësishëm për BE-në.



## ANEKSI

### Konkludime mbi Malin e Zi, Serbinë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Turqinë dhe Islandën

#### Mali i Zi

Hapja e negociatave për anëtarësim në BE me Malin e Zi në qershor të vitit 2012 ka shënuar fillimin e një faze të re dhe intensive për Malin e Zi në rrugën e tij drejt BE-së. Reformat e thella dhe të gjata të nevojshme për zbatimin e qasjes së re në Kapitullin 23 mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore dhe kapitullin 24 mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë kërkon një vullnet të fort politikë dhe kapacitete të shtuar administrativ. Procesi i anëtarësimit duhet të jetë gjithëpërfshirës, me përfshirje të fuqishme të shoqërisë civile gjatë gjithë procesit.

Gjatë periudhës raportuese, Mali i Zi është përqendruar në përgatitjen e planeve gjithëpërfshirëse të veprimit të cilat do të udhëzojnë procesin reformues të vendit sa i përket sundimit të ligjit. Në qershor, qeveria miratoi këto plane të veprimit të cilat përbëjnë kriteret hyrëse për kapitujt 23 dhe 24. Pasuar miratimin e planeve të veprimit, Komisioni, në muajin gusht rekomandoi hapjen e këtyre kapitujve dhe në shtator Këshilli ftoi Malin e Zi që të parashtrij pozicionin e saj negociues. Puna është duke proceduar në përputhje me qasjen e re në këto kapituj të përcaktuar në kornizën për negociata me Malin e Zi.

Takimet monitoruese për të gjithë kapitujt negociues janë përfunduar në fund të muajit qershor 2013. Deri më tani, negociatat në dy kapitujt (shkencë dhe hulumtim; Arsim dhe kulturë) janë mbyllur përkohësisht. Kriteret hyrëse janë përcaktuar për gjashtë kapituj (lëvizja e lirë e mallrave, e drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime; politika e konkurrencës, zhvillimi bujqësor dhe rural, siguria e ushqimit, politikat veterinerë dhe fitosanitare, politikat rajonale dhe koordinimi i elementeve strukturore).

Reforma e administratës publike është prioritet për të siguruar se Mali i Zi ka kapacitet që të aplikoj *acquis-in*, për të trajtuar politizimin dhe të rris transparencën dhe profesionalizmin e shërbimit civil. Ngjarjet gjatë muajve të fundit, në veçanti përdorimi i supozuar i fondeve publike për qëllime politike të partisë, ka nënvizuar rëndësinë e fuqizimit të besimit të qytetarëve në institucionet publike. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që të sigurohemi se hetimet kanë përfunduar plotësisht dhe në mënyrë të shpejtë dhe veprimi i duhur është ndërmarrë. Gjithashtu nevojitet përcjellje adekuate e punës së grupit parlamentar për procesin zgjedhor. Mali i Zi gjithashtu duhet të siguroj një përcjellje adekuate në rekomandimet e vjetra të OSBE/ODIHR mbi legjislacionin e saj zgjedhor dhe të vendos një linjë ndarëse mes interesave publike dhe partiake. Mali i Zi vazhdon që të përmbushë mjaftueshëm **kriteret politike** për anëtarësim në BE. Zgjedhjet parlamentare dhe ato presidenciale të tetorit të vitit 2012 dhe respektivisht të muajit prill 2013, nuk e ka ndryshuar prioritetin strategjik të dhënë nga vendi, me synim të anëtarësimit në BE. Derisa këto zgjedhje janë klasifikuar nga OSBE/ODHIR si të administruara në mënyrë profesionale dhe efektive, gjithashtu janë identifikuar disa mangësi. Mos pranimi i rezultateve të zgjedhjeve presidenciale nga opozita, ka rezultuar me një bojkot dy mujor të parlamentit nga grupi më i madh opozitar. Bojkoti ka përfunduar kur është arritur një marrëveshje ndër-partiake për të formuar dy organe parlamentare për ti hetuar akuzat për abuzim të fondeve publike për qëllime të zgjedhjeve dhe që të hartojnë rekomandimet për të përmirësuar procesin zgjedhor. Komisioni hetues parlamentar ka përfunduar punën e vet në muajin qershor për keqpërdorimet e dyshuara të fondeve publike. Parlamenti dështoi të pajtohet mbi konkludimet që, *ndër të tjera*, do të krijonin përgjegjësi politike dhe e kufizoj vetën me një raport teknik. Përcjellja gjyqësore mbetet të sigurohet.

Grupi punues për ndërtimin e besimit në procesin zgjedhor tashmë ka miratuar draft ligjin në një listë të vetme të votuesve, për të zëvendësuar ligjin për regjistrin e votuesve, si dhe të hartoj ndryshime për ligjin për letërnjoftimet. Në fushën e sundimit të ligjit, parlamenti ka miratuar ndryshimet e shumë pritura për fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit, të cilat janë gjerësisht në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Mali i Zi është i përfshirë në mënyrë aktive në bashkëpunimin policor dhe gjyqësor ndërkombëtar. Përderisa janë nxjerr disa vendime në lidhje me trafikimin e drogës, vetëm disa raste iu janë referuar krimeve të tilla siç është trafikimi me qeniet njerëzore dhe pastrim të parave. Disa dënime të instancës së parë në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin janë rikthyer për gjykim. Mosdëshkimi në lidhje me rastet e keqtrajtimit të të burgosurve mbetet një shqetësim serioz.

Mali i Zi ka marr një rol udhëheqës në promovimin e bashkëpunimit regjional, në veçanti përmes propozimit të tij për themelimin e iniciativës “Ballkani Perëndimor Gjashtë” (Western Balkans Six).

Sa i përket Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Mali i Zi ende ruan marrëveshjen bilaterale për imunitetit të vitit 2007 me Shtetet e Bashkuara, që ofron përjashtime nga juridiksioni i gjykatës. Mali i Zi duhet të përafrohet me pozicionin e BE-së.

Duke shikuar në të ardhmen, Mali i Zi duhet të siguroj përcjelljen politike dhe gjyqësore për keqpërdorimin e dyshuar të fondeve publike për qëllime politike partiake. Gjithashtu duhet të kryej në tërësi punën e grupit parlamentar mbi procesin zgjedhor, duke miratuar masat legislative dhe masat e tjera për të zgjeruar mbështetjen politike dhe për të rritur besimin e publikut në procesin zgjedhor dhe institucionet shtetërore.

Rritja e besimit të publikut në shtet është e lidhur ngushtë me fuqizimin e më tejshëm të sundimit të ligjit. Zbatimi me kohë dhe efektiv i planeve të veprimit të Malit të Zi, në këto fusha do të luaj një rolë qendror. Fokus i veçantë duhet ti kushtohet reformave që përmirësojnë pavarësinë, llogaridhënien dhe profesionalizmin e gjyqësorit, duke përfunduar ruajtjen e integritetit, si dhe emërimet të bazuara në merita. Zbatimi i ndryshimeve kushtetuese do të luaj një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Paralelisht, Mali i Zi duhet të zhvilloj regjistrin e vet sa i përket hetimit dhe ndjekjes sistematike të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshi edhe rastet e nivelit të lartë, si dhe në lidhje me shqiptimin e sanksioneve që janë në proporcion me peshën e krimeve të kryera.

Liria e shprehjes duhet të forcohet, duke përfshirë hetimin e duhur të të gjitha rasteve të dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe sjelljen e kryesve të veprave para drejtësisë. Kërkohe vëmendje e shtuar për të trajtuar mangësitë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga gjyqësori dhe autoritetet për zbatimin e ligjit, posaçërisht sa i përket grupeve të rrezikuara. Komuniteti Romë përballet me diskriminim, posaçërisht në lidhje me të drejtat sociale dhe ekonomike, dhe mbesin të nën-përfaqësuar në nivel politik. Aktivistët e komunitetit lesbike, homoseksual, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI) janë ende të ekspozuar ndaj diskriminimit, sulmet nuk raportohen aq shpesh dhe ndëshkimet ende duhet të fuqizohen.

Miratimi i planit për riorganizimin e sektorit publik dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri për shërbyesit civil dhe punonjësit shtetëror janë hapa pozitivë. Rekrutimi i drejtë dhe konkurruese i nëpunësve civilë është një parakusht për të zhvilluar një administratë profesionale. Letrat e dorëheqjes pa datë të shënuar janë një çështje shqetësuese dhe duhet të kthehet tek stafi i cili i nënshkroi ato.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Mali i Zi ka bërë progres të mëtjshëm drejt një ekonomie funksionale të tregut. Vendi duhet të jetë në gjendje për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në periudha afat-mesme, me kusht që ajo të vazhdoj të adresojë dobësitë aktuale përmes politikave të përshtatshme makroekonomike dhe reformave strukturore.

Pas hyrjes në recesion në vitin 2012, vendi doli nga recesioni në vitin 2013. Elasticiteti i turizmit dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD) së bashku me një rritje të eksporteve të energjisë elektrike ka mbështetur rimëkëmbjen, duke kompensuar kërkesën e dobët vendore. Deficiti aktual i llogarisë rrjedhëse është në rënie, por ende mbetet shumë i lartë. Në muajin korrik, prodhuesi i aluminit KAP ishte vënë në procedurë të falimentimit, e cila përbën një rrezik për financat publike, për shkak të madhësisë së konsiderueshme të detyrimeve

kontingjente. Papunësia ka mbetur shumë e lartë. Rritja e kredisë u kthye pozitive pas katër viteve tkurje, por nivelet e larta të kredive të këqija ende peshojnë mbi kapitalizmin e bankës dhe mbi furnizimin me kredi.

Për tu përballuar me sfidat ekzistuese ekonomike dhe për të reduktuar zhbalancimet e jashtme, Mali i Zi ka nevojë për të forcuar konkurrencën, duke përmirësuar produktivitetin dhe tërheqjen e IHD-ve të mëtejshme në më shumë sektorë se turizmi dhe pasuritë e patundshme. Krijimi i një mjedisi të shëndoshë biznesi vazhdon të pengohet nga sundimi i dobët i ligjit dhe korrupsioni. Shkalla e lartë e papunësisë kërkon tejkalimin e hendekut në mes të kërkesës dhe ofertës së aftësive të punës dhe duke lejuar kështu vendosjen më të pavarur të pagave në nivel të kompanisë. Kjo gjithashtu kërkon forcimin e shërbimit të punësimit publik në mënyrë që të zbatohen politikat e aktivizimit dhe të krijojë një treg gjithëpërfshirës dhe efikas të punës. Autoritetet duhet të konsiderojnë objektivistisht qëndrueshmërinë e konglomeratit të aluminit në kushtet e tregut dhe zgjidhjen më të mirë të mundshme, pa rënduar presionin mbi financat publike. Shtegu i konsolidimit fiskal duhet të vazhdohet, duke përfshirë edhe përpjekjet për mbledhjen e taksave të mbetura. Niveli i lartë i kredive të këqija mbetet një çështje shqetësuese dhe bën thirrje për një mbikëqyrje të përforcuar bankare që zbaton ndalesa të përshtatshme. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

**Sa i përket aftësisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE,** Mali i Zi është në shkallë të ndryshme të përafrimit. Forcimi i kapaciteteve administrative është një sfidë ndër-sektoriale në shumë fusha. Në kapitujt, të tilla si prokurimi publik, ligji i kompanive, të drejtën e pronësisë intelektuale, shoqëria informative dhe mediat, tatimet, ndërmarrjet dhe politika industriale, Mali i Zi ka avancuar mjaft sa i përket asaj që Komisioni të mund të rekomandoj hapjen e negociatave për anëtarësim.

Në fusha të tjera, të tilla si lëvizja e lirë e mallrave; e drejta për themelimin dhe liria për të ofruar shërbime; bujqësia dhe zhvillimi rural; siguria ushqimore, politikat veterinarë dhe fito-sanitare, politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore, kriteret fillestare - shpesh duke përfshirë edhe strategjitë për përafrimin me *acquis-in* – janë të vendosura. Këto kriterë tani duhet të udhëheqin punën e Malit të Zi në muajt e ardhshëm. Për kapitullin e politikës së konkurrencës, është veçanërisht urgjente të përpunohet një plan ristrukturimi për prodhuesin e aluminit KAP, në mënyrë që të sjellë Malin e Zi në përputhje me detyrimet e veta sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, janë të nevojshme shumë përpjekje të konsiderueshme, duke përfshirë planifikimin strategjik, për të siguruar harmonizimin dhe zbatimin e *acquis-it*.

## **Serbia**

Viti 2013 ka qenë një vit historik për Serbinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Serbia ka punuar në mënyrë aktive dhe konstruktive drejt një përmirësimi të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Kosovën. Në prill, angazhimi i Serbisë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja rezultoi me *'Marrëveshjen e parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve'* (Marrëveshja e parë), e cila u plotësua në maj me planin e zbatimit. Të dyja palët, në veçanti, kanë rënë dakord që asnjëra palë nuk do të bllokojë, apo të inkurajojë të tjerët për të bllokuar, progresin e palës tjetër në rrugën e tyre përkatëse për në BE. Kjo paraqet një ndryshim rrënjësor në marrëdhëniet midis të dy palëve. Implementimi i Marrëveshjes së Parë ka vazhduar dhe tashmë ka dërguar në një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren. Palët kanë arritur marrëveshje mbi energjinë dhe telekomunikacionin. Ka pasur gjithashtu progres në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun teknik dhe bashkëpunimi i Serbisë me EULEX-in ka vazhduar të përmirësohet në një numër të fushave.

Serbia ka riaktivizuar vrullin e reformave dhe ka përsheptuar kontaktet e nivelit të lartë me vendet fqinje në një përpjekje për të siguruar një kontribut pozitiv në bashkëpunimin rajonal. Serbia ka ndërmarrë disa hapa për të konsoliduar gjendjen e saj fiskale dhe për të përmirësuar mjedisin biznesor. Ajo vazhdoi përafrimin e legjisllacionit të saj me kërkesat e legjisllacionit të BE-së në shumë fusha, të cilat tani janë të monitoruara në kuadër të Planit Kombëtar për

Miratimin e Acquis-it për periudhën 2013-2016. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit mes BE-së dhe Serbisë hynë në fuqi më 1 shtator.

Si rezultat i arritjes së përparimit të konsiderueshëm, është hapur një fazë e re në marrëdhëniet mes Serbisë dhe Bashkimit Evropian. Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit më 28 qershor, pas rekomandimit të Komisionit të datës 22 prill. Komisioni e parashtrroi propozimin e tij për një kornizë të negociatave tek Këshilli më 22 korrik. Komisioni gjithashtu filloi ekzaminimin analitik të *acquis-it* të BE-së ('monitorimit') në shtator. Korniza negociuese pritet të miratohet shpejt nga Këshilli dhe të konfirmohet nga Këshilli Evropian me qëllim të mbajtjes së konferencës së parë ndër-qeveritare mbi anëtarësimin e Serbisë më së largu deri në janar të vitit 2014.

Në këtë fazë të re të vështirë të marrëdhënieve BE-Serbi, Serbia duhet të intensifikoj më tej përpjekjet e saj për të arritur përmbushjen e plotë me të gjitha kriteret e anëtarësimit. Do të jetë gjithashtu vendimtare të komunikuarit e rregullt të përfitimeve dhe mundësive që i krijon procesi i anëtarësimit për të gjithë qytetarët në Serbi, përgjatë tërë rrugës së anëtarësimit.

Në mesin e sfidave kryesore me të cilat ajo përballlet, Serbia duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë fushave kryesore të sundimit të ligjit, veçanërisht reformës së gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe luftën kundër krimit të organizuar, reformës së administratës publike, pavarësinë e institucioneve kyçe, lirinë e mediave, mos-diskriminimin dhe mbrojtjen e pakicave.

Serbia duhet të mbetet plotësisht e angazhuar për normalizimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve me Kosovën dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog, duke përfshirë edhe bashkëpunimin adekuat me EULEX-in. Serbia duhet të përfundojë në veçanti zbatimin e marrëveshjes së parë për policinë, drejtësinë dhe zgjedhjet komunale në Kosovë. Është e rëndësishme që Serbia të vazhdon të inkurajojë pjesëmarrjen e gjerë të serbëve të Kosovës në zgjedhjet e ardhshme lokale në Kosovë. Zbatimi i plotë i parimit të bashkëpunimit gjithëpërfshirës rajonal mbetet të sigurohet, duke përfshirë shmangien e problemeve siç ishte ai i hasur në samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF). Serbia pritet të vazhdojë të japë një kontribut aktiv në bashkëpunimin dhe pajtimin rajonal.

Serbia i përmbush në mënyrë të mjaftueshme **kriteret politike**. Qeveria ka ndjekur në mënyrë aktive agjendën e integritimit në BE, duke demonstruar konsensus në vendimet kryesore politike dhe duke avancuar procesin e konsultimit. Parlamenti ka përmirësuar transparencën e punës së tij, procesin e konsultimit mbi legjislacionin si dhe mbikëqyrjen e saj të ekzekutivit. Megjithatë, parlamenti ende shpesh aplikon procedura urgjente, të cilat padrejtësisht e kufizojnë kohën dhe debatin për shqyrtimin e projektligjeve.

Serbia i ka kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të sundimit të ligjit, që do të jetë një çështje kyçe, në përputhje me qasjen e re mbi Kapitujt 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe 24 (drejtësia, liria dhe siguria). Serbia miratoi strategji të reja gjithëpërfshirëse në fushat kyçe të gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe mos-diskriminimit pas një procesi të gjerë konsultimi. Ishte një qasje e dukshme proaktive ndaj hetimeve në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rastet e nivelit të lartë. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar gjithashtu ka dërguar në disa rezultate në luftën kundër krimit të organizuar. Janë nisur hetime penale për një numër të rasteve por dënimet përfundimtare mbeten të rralla në këto fusha. Serbia gjithashtu ka vazhduar të bashkëpunojë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY).

Sa i përket lirisë së shprehjes, shpifja ka qenë e dekriminalizuar. Në përputhje me përkushtimet e mëhershme për përfshirjen e romëve, masat janë zbatuar dhe është miratuar një plan i ri veprimi. Korniza ligjore për mbrojtjen e pakicave në përgjithësi mbetet e respektuar, por zbatimi i saj konsekuent në tërë Serbinë mbetet për t'u aranzhuar në fushat siç janë arsimit, përdorimin i gjuhës, qasja në media si dhe shërbime fetare në gjuhën e pakicës. Edhe pse disa përpjekje shtesë janë bërë nga autoritetet dhe institucionet e pavarura për

mbrojtjen e grupeve të tjera të rrezikuara në veçanti të personave nga komuniteti lezbian, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI), prapë se prapë u mungon mbështetja e mjaftueshme politike. Ishte në veçanti për keqardhje që parada e krenarisë u ndalua për të tretin vit me radhë për shkaqe të sigurisë, kjo ishte një mundësi e humbur për të demonstruar respekt për të drejtat themelore.

Në perspektivë, Serbia duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë forcimit të pavarësisë së institucioneve kyçe dhe sidomos gjyqësorit. Korniza kushtetuese dhe legjislativë ende lë hapësirë për ndikimet politike, veçanërisht kur është fjala për rolin e parlamentit në emërimet dhe shkarkimet gjyqësore. Reformat e mëtejshme do të kërkojnë një analizë të plotë funksionale të gjyqësorit në aspektin e kostos, efikasitetit dhe qasjes në drejtësi. Duhet të forcohet seriozisht ekspertiza e Serbisë që në mënyrë efektive të hetoj, ndjek penalisht dhe dënojë kryerësit e veprave për korrupsion dhe krim të organizuar. Zbatimi i ndryshimeve të fundit në legjislacionin mbi 'keqpërdorimin e detyrës' duhet të monitorohet me kujdes me qëllim të një shqyrtimi të plotë të krimeve ekonomike. Duhet të krijohet legjislacioni efektiv për mbrojtjen e denoncuesve. Zbatimi efektiv i strategjive dhe planeve të veprimit në fushat e gjyqësorit dhe anti-korrupsionit do të testoj gatishmërinë dhe vullnetin e Serbisë për të ecur përpara. Këto dokumente strategjike mund të kërkojnë përshtatje të mëturshme të ushtrimit të monitorimit.

Qeveria gjithashtu ka nevojë të përmirësoj drejtimin e saj në fushën e reformës së administratës publike dhe të zhvillojë më tej një sistem të shërbimit civil transparent dhe të bazuar në merita. Korniza ligjore për shërbimin civil në nivel lokal mbetet për t'u zbatuar dhe zhvilluar në mënyrë adekuate.

Më tepër vëmendje duhet t'i kushtohet lirisë së mediave. Serbia duhet tani të çojë përpara zbatimin e strategjisë së mediave duke filluar me miratimin e legjislacionit të paraparë mbi informimin publik dhe mediat, mbi transmetuesit e shërbimit publik dhe mbi komunikimet elektronike. Financimi i drejtpërdrejtë nga shteti dhe kontrolli i mediave, si dhe qëndrueshmëria e transmetuesve publik mbeten çështje kyçe që duhet trajtuar. Duhet të miratohet dhe të zbatohet plani i veprimit të strategjisë së mos-diskriminimit. Autoritetet duhet të rrisin mbrojtjen e mediave, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe grupeve tjera të rrezikuara, duke përfshirë edhe komunitetin LGBTI nga kërcënimet dhe sulmet e grupeve radikale. Progresi i kohëve të fundit për të përmirësuar gjendjen e pakicave, duke përfshirë romët, duhet të fuqizohet edhe më tej me kalimin e kohës përfshirë këtu edhe burime financiare shtesë. Duhet ti kushtohet vëmendje e vazhdueshme çështjes së banimit dhe qasjes në dokumente për romët. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet rajoneve të cilat përballet me kushte të rënda socio-ekonomike, sidomos në jug dhe lindje të Serbisë. Zgjedhjet për Këshillat Nacionale të Minoriteteve në vitin 2014 do të sigurojnë një mundësi të mirë për Serbinë për të riafirmuar angazhimin e saj për mbrojtjen e minoriteteve. Proces i zgjedhor duhet të zhvillohet me kujdes, duke marrë parasysh rekomandimet e kaluara nga institucionet e pavarura.

Do të jetë e rëndësishme që Serbia të vazhdojë të japë një kontribut aktiv në bashkëpunimin rajonal dhe zhvillon më tej lidhjet e saj me vendet fqinje, duke përfshirë edhe trajtimin e çështjeve të pazgjidhura dypalëshe.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Serbia ka bërë disa përparime drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Serbia duhet të bëjë përpjekje domethënëse në ristrukturimin e ekonomisë së saj në mënyrë që të përballet në periudhën afatmesme me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Në vitin 2012, Serbia kaloi nëpër një recesion të radhës dhe ekonomia u tkurr për 1.7%. Rritja e lartë e eksporteve ka zbutur efektet e kërkesës së ulët të brendshme dhe dërgoi në një rimëkëmbje të lehtë dhe të pabarabartë në gjysmën e parë të vitit 2013. Është ndërmarr një seri përpjekjesh për konsolidimin fiskal më së shumti sa i përket të hyrave. Proces i ristrukturimit të ndërmarrjeve shtetërore është rigjallëruar. Disa përparime janë bërë në lidhje

me luftën kundër korrupsionit si dhe në përmirësimin e të drejtave pronësore.

Rritja mbetet me bazë të ngushtë dhe shenjat e para të rimëkëmbjes ekonomike në vitin 2013 nuk u përhapen në tregun e punës. Papunësia dhe deficitet buxhetor mbeten shumë të lartë. Vazhduan ngurtësitë në tregun e punës dhe krijimi i punësimit të qëndrueshëm paraqet një sfidë të madhe. Ende mungon adaptimi i një programi të besueshëm afatmesëm i rregullimit fiskal. Prania e shtetit në ekonomi është e rëndësishme dhe kompanitë shtetërore vazhduan të grumbullojnë humbje të mëdha. Serbia duhet të vazhdojë përmirësimin e mjedisit biznesor dhe duhet të bëjë përpjekje të forta për të zhvilluar një sektor privat konkurrues. Funksionimi i mekanizmave të tregut është penguar nga pasiguria ligjore dhe korrupsioni. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Sa i përket **aftësisë së saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, Serbia ka vazhduar përafrimin e legjislacionit të saj me kërkesat e legjislacionit të BE-së në shumë fusha, përpjekje këto që u përforcuan me miratimin e një Plani Kombëtar për miratimin e *acquis-it*. Progres i mirë është regjistruar në prokurimin publik, me miratimin e Ligjit të ri mbi Prokurim Publik, i cili parashikon përafrimin të mëtejshëm me *acquis-in* e BE-së dhe përfshin dispozita të përmirësuara në parandalimin e korrupsionit. Çështja e pavarësisë së bankës qendrore është adresuar pjesërisht me ndryshimet në ligj. Dy ligje të reja u miratuan në fushat e kontabilitetit dhe auditimit të korporatave, duke synuar përafrimin e mëtejshëm në fushën e Ligjit mbi kompanitë. Është përmirësuar korniza institucionale për politika të NVM-ve dhe qasja e NVM-ve në financa. Masat e ndërmarra për të përmirësuar mjedisin biznesor, në veçanti në vlerësimin e ndikimit të biznesit për legjislacionin e ri, janë në një zhvillim i mirëpritur. Regjistrimet e popullsisë dhe bujqësisë kanë përfunduar me sukses. Megjithatë, ndryshimet në ligjin mbi të drejtën e autorit në lidhje me mbledhjen e gjobave dhe përjashtimet, përbëjnë një hap prapa në përafrimin me *acquis-in* e BE-së.

Në perspektivë, Serbia duhet të dyfishojë përpjekjet e veta për t'u përafruar me *acquis-in* e BE-së me vëmendje të veçantë në zbatimin efektiv të legjislacionit të miratuar. Në veçanti, Serbia duhet të intensifikojë përpjekjet në drejtim të përafrimit në fushat e tilla si: uji, menaxhimi i mbeturinave, cilësisë së ajrit dhe mbrojtjes së natyrës, dhe në drejtim të hapjes së tregut, tarifave të ndara dhe reflektive të kostos në sektorin e energjisë. Gjithashtu nevojiten përpjekje të mëtejshme edhe në fushat e kontrollit të ndihmës shtetërore, ku pavarësia e Komisionit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore duhet të themelohet edhe më tej dhe përjashtimi i ndërmarrjeve nën privatizim nga rregullat e Ndhmës Shtetërore duhet të shfuqizohet. Sistemet e mbrojtjes sociale, marrëdhëniet e punës dhe dialogut social duhet të forcohet ndjeshëm, sidomos në nivelin e dialogut social trepalësh. Ligji mbi OMGJ-të duhet të përafrohet me legjislacionin e BE-së për të mundësuar anëtarësimin në OBT. Nevojiten përpjekje të mëtejshme thelbësore për zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të sektorit publik bazuar në konceptin themelor të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe për të zhvilluar kapacitetin e plotë të auditimit të jashtëm.

Marrëveshja e Përkohshme (MP) e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) vazhdon të zbatohet pa probleme.

### **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte vendi i parë që nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me BE-në në vitin 2001. Ajo ka qenë një vend kandidat për tetë vjet, që nga Opinioni pozitiv i Komisionit në nëntor të vitit 2005 dhe vendimit të Këshillit në dhjetor të vitit 2005. Që nga viti 2009, Komisioni ka vlerësuar se vendi i përmbush mjaftueshëm kriteret politike dhe rekomandoi hapjen e negociatave. Komisioni gjithashtu ka rekomanduar, që nga viti 2009, se duhet të fillojë faza e dytë e asociimit në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Asnjë vendim nuk është marrë nga Këshilli në të dyja rastet. Njëzet vjet pas hyrjes së vendit në Kombet e Bashkuara, një zgjidhje për çështjen e emrit duhet të gjendet pa vonesë të mëtejshme.

Në mungesë të procesit të negociatave, forumet kryesore për diskutim dhe monitorim të reformave janë organet e themeluara në bazë të MSA-së, ashtu sikurse edhe Dialogu i Nivelit të Lartë për Anëtarësim (DNLA) i themeluar në vitin 2012. DNLA-ja ka kontribuar për progres në shumicën e fushave prioritare. Progresi i bërë nën DNLA-në do ta mban vendin në pozicion të mirë kur të fillojnë negociatat. Megjithatë, kjo nuk është dhe nuk mund të jetë zëvendësim për të kaluar në hapjen e negociatave për anëtarësim.

Kriza politike që pasoi ngjarjet në parlament në fund të vitit të kaluar ka vënë në pah ndarjet e thella në mes të partive politike që ndikojnë në funksionimin e parlamentit dhe demonstuan nevojën për politika konstruktive në interes kombëtar. Gjatë miratimit të buxhetit për vitin 2013, largimi me forcë i deputetëve të opozitës dhe gazetarëve nga salla e parlamentit rezultoi që grupimi më i madh opozitarë të bojkoton parlamentin duke kërcënuar në një bojkot të zgjedhjeve lokale. Ngecja e stërzgatur u zgjidh përmes zbatimit të marrëveshjes politike të 1 marsit. Kjo përfshiu kthimin e deputetëve të opozitës në parlament, pjesëmarrjen në zgjedhjet komunale, rekomandimet e Komitetit Hetimor për të ardhmen, nënshkrimi i memorandumit ndërpartiak të mirëkuptimit mbi objektivat e strategjisë kombëtare Euro-Atlantike, dhe punën e mëtejshme në reformat zgjedhore. Rinisja e dialogut mes qeverisë dhe gazetarëve mbetet diskutabile. Konsensusi mbi raportin e Komisionit Hetimor tregoi se me vullnet politik mund të gjenden zgjidhje konstruktive përmes dialogut dhe kompromisit. Rekomandimet e Komisionit Hetimor duhet të zbatohet në mënyrë të plotë.

Në përgjithësi, vendi vazhdon të përmbushë mjaftueshëm **kriteret politike**. Zgjedhjet komunale në muajt mars/prill 2013 u vlerësuan nga OSBE/ODIHR si të administruara në mënyrë profesionale dhe efikase, megjithëse është vënë në dukje paqartësia e dallimit në mes të shtetit dhe të partisë si dhe ka rekomanduar ndryshimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor. Vendi ka përfunduar pjesën më të madhe të reformave të gjyqësore në mes viteve 2004 dhe 2010. Progres i mëtejshëm është bërë këtë vit në fushën e efikasitetit të gjyqësisë. Progres është bërë edhe me krijimin e të dhënave gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e ekspertizës së anti-korrupsionit, që duhet të zhvillohet në të ardhmen. Sa i përket lirisë së shprehjes, progresi në dialogun me mediat ka ngecur pas dëbimit të gazetarëve nga parlamenti dhe pavarësisht zhvillimeve në kornizën legjislative, reputacioni i vendit përkitazi me lirinë e mediave është përkeqësuar. Gjithashtu, mbyllja e një numri të mediave në vitet e fundit e ka reduktuar diversitetin e këndvështrimeve të ndryshme që janë në dispozicion për qytetarët.

Pasi që vendi ka arritur tashmë një nivel të lartë të përafrimit, në krahasim me atë se ku gjendet në procesin e anëtarësimit, prioritet për vitin e ardhshëm duhet të jenë zbatimi efektiv dhe fuqizimi i kornizave ekzistuese ligjore dhe politike, të ngjashme me vendet tashmë të angazhuara në bisedimet e anëtarësimit.

Në fushën e sundimit të ligjit, duhet të rriten më tej pavarësia dhe kompetencat e gjykatave dhe fokusimi të jetë më i madh në cilësinë e drejtësisë së ofruar për qytetarin. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz. Vendi duhet të demonstrojë efekt të prekshëm të masave ekzistuese anti-korrupsion dhe të zbatoj në mënyrë efektive masat për të trajtuar krimin e organizuar. Sa i përket lirisë së shprehjes, shkalla e lartë e polarizimit të mediave, shpesh përgjatë linjave politike, pengon zhvillimin e raportimit objektiv, vendos presionin ekonomik ndaj gazetarëve dhe pronarëve të mediave (duke përfshirë edhe përmes përdorimit të pakuptueshëm të reklamave qeveritare) dhe nxit standarde të dobëta profesionale. Dialogu në mes të qeverisë dhe përfaqësuesve të mediave duhet të ri-fillojë dhe të prodhojë rezultate konkrete në ndryshimin e kulturës së mediave si dhe krijimin e një klime të ndërtimit të besimit dhe mirëbesimit. Rekomandimet e mbetura të ODIHR-it duhet të zbatohen plotësisht. Strategjia për romët duhet të zbatohet në mënyrë proaktive. Duhet më shumë veprim për të denoncuar jo-tolerancën p.sh. *vis-à-vis* komunitetit të lezbian, homoseksua, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI).

Është gjithashtu urgjente që të përfundohet rishikimi i *Marrëveshjes Kornizë të Ohrit*, që është veçanërisht i rëndësishëm për marrëdhëniet ndër-etnike dhe ndërmjet komuniteteve dhe

rekomandimet e saj të zbatohen. Kjo, decentralizimi i vazhdueshëm si dhe elementet kyçe të Marrëveshjes do të kontribuojnë në stabilitetin e vendit dhe më gjerë.

Vendi përgjithësisht mban marrëdhënie të mira me vendet e tjera aspirante dhe luan një rol aktiv në *bashkëpunimin rajonal*. Është e rëndësishme qasja konstruktive në marrëdhëniet me shtetet fqinje që janë anëtare të BE-së. Duhet shmangur veprimet dhe deklaratat të cilat ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, vendi është i avancuar mirë dhe në disa fusha, ka bërë progres të mëtjshëm drejt shndërrimit në një ekonomi funksionale tregu. Vendi duhet të jetë në gjendje të përballet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në një periudhë afatmesme, me kusht që të zbaton fuqishëm programin e saj të reformave për të reduktuar dobësitë e konsiderueshme strukturore.

Aktiviteti ekonomik ka stagnuar në vitin 2012, me një rifillimin të rritjes në gjysmën e parë të vitit 2013. Kundruall sfondit të një mjedisi sfidues të jashtëm, është ruajtur stabiliteti makroekonomik. Papunësia mbetet shumë e lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve. Deficiti në rritje dhe nivelet e borxhit publik e kanë rritur cenueshmërinë e vendit.

Duhet të ndërmerren masa në mënyrë që të adresohen arsyet themelore për papunësinë e lartë, në veçanti trajtimi i mospërputhjes së aftësive. Duhet të forcohet qëndrueshmëria e financave publike. Politika fiskale duhet të jetë një linjë me prioritetet e vendit për reforma strukturore dhe të orientuara drejt rritjes duke shtuar shpenzimet. Aplikimi i kornizës afatmesme fiskale dhe planifikimit strategjik do të kontribuojë për forcimin e disiplinës fiskale. Nevojiten përpjekje të mëtjshme për të zbatuar në mënyrë efektive menaxhimin financiar publik, në mënyrë që të sigurohet përdorimi më efikas dhe më transparent i resurseve publike dhe të BE-së. Për të siguruar më shumë investime të sektorit privat, nevojiten përpjekje të mëtjshme për të përmirësuar mjedisin afarist, i cili është prekur negativisht nga korrupsioni si dhe procedurat e gjata dhe të kushtueshme të daljes nga tregu. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Vendi ka bashkëpunim të thellë dhe të gjerë me BE-në në të gjitha fushat e *acquis* dhe është në një nivel të avancuar të përafrimit legjislativ në nivel strategjik dhe institucional, tani me fokus në kapacitetet administrative dhe mekanizmat e koordinimit brenda administratës kombëtare për të siguruar zbatimin efektiv. Vendi ka bërë progres të mëtjshëm në përmirësimin e **aftësisë së tij për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**. Vendi vazhdon të përmbushë zotimet e tij në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (MSA), në prag të dhjetëvjetorit të hyrjes në fuqi të MSA-së.

Në fushën e tregut të brendshëm, është arritur një nivel i mirë i përafrimit legjislativ në fushat e lëvizjeve të kapitalit, shërbimeve postare dhe ligjit mbi kompanitë. Në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, vendi ka përparuar mjaft mirë në përgatitjet për politikën e vizave, kufijve të jashtëm, Shengenit dhe bashkëpunimit policor. Sa i përket reformës së administratës publike, duhet të vazhdojë puna në zbatimin e parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të barabartë. Nevojiten përpjekje të mëtjshme veçanërisht në fushat e politikës rajonale, mjedisit, dhe ndryshimeve klimatike ku duhet të përmirësohet zbatimi i projekteve të financuara e BE-ja e po ashtu edhe cilësia e ujit, kontrolli i ndotjes industriale dhe menaxhimi i rrezikut. Sa i përket politikës sociale dhe punësimit nevojiten masa për të arritur një treg gjithëpërfshirës dhe efikas të punës. Kontrolli i brendshëm financiar publik duhet të forcohet dhe zhvillohet në tërë administratën publike. Në përgjithësi, vendi ka arritur një nivel të përafrimit me *acquis* mjaftueshëm për të lëvizur në fazën e ardhshme të procesit të anëtarësimit.



## Shqipëria

Tetorin e kaluar, Komisioni i rekomandoi se Këshilli duhet t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat që i nënshtrohet plotësisht të masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe administratës publike dhe rishikimin e rregullores së punës së parlamentit. Në dhjetor të vitit 2012, me qëllim që të vendoset nëse duhet dhënë statusi i kandidatit, Këshilli ftoi Komisionin që të raportojë para të arrihet progresi i nevojshëm, gjithashtu duke marrë parasysh veprimet e mëtejshme të ndërmarra nga Shqipëria për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, përfshirë hetimet proaktive dhe ndjekjet penale të rasteve të tilla. Në këtë drejtim, Shqipëria me konsensus ndërpartiak i ka miratuar masat kyçe të mbetura mbi reformat e gjyqësorit, administratës publike dhe parlamentare. Zgjedhjet parlamentare në qershor u vlerësuan nga misioni ndërkombëtar vëzhgues i zgjedhjeve i udhëhequr nga OSBE/ODIHR-it si konkurruese me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve gjatë gjithë fushatës dhe respektit të mirëfilltë për liritë themelore. Në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Shqipëria ka ndërmarrë hapa fillestarë drejt përmirësimit të efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjeve penale dhe forcimit të bashkëpunimit midis organeve të zbatimit të ligjit. Numri i dënimeve në korrupsion dhe në rastet e pastrimit të parave është rritur, sikurse edhe numri i hetimeve mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogës. Të gjitha rekomandimet e fundit të Këshillit të Evropës në lidhje me financimin e partive politike dhe dispozitat ligjore mbi korrupsionin janë adresuar në mënyrë të kënaqshme. Qeveria e re në Shqipëri ka bërë një zotim të fortë për të luftuar korrupsionin dhe i ka dhënë prioritet kësaj çështje në programin e saj.

Përtej Opinioneve të Komisionit të vitit 2010, Shqipëria duhet të përmbushë prioritetet e mëposhtme kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Shqipëria duhet: 1) të vazhdojë të zbatojë reformën e administratës publike me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe depolitizimit të administratës publike; 2) të ndërmerr veprime të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve gjyqësore; 3) të bëjë përpjekje të vendosura të mëtejshme në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë krijimin e një regjistri solid për hetimet proaktive, ndjekjes penale dhe dënimeve; 4) të bëjë përpjekje të vendosura të mëtejshme në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë krijimin e një dosje solide të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve; 5) të ndërmerr masa efektive për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë ato të romëve dhe të politikave anti-diskriminuese, si dhe zbatimin e të drejtave pronësore.

Dialogu konstruktiv dhe i qëndrueshëm mes qeverisë dhe opozitës mbi reformat lidhur me BE-në do të jetë jetik në sigurimin e të ardhmes së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Angazhimi konstruktiv i Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal mbetet thelbësorë.

Shqipëria ka bërë përparim të mëtejshëm drejt përmbushjes së **kritereve politike** për anëtarësim në BE. Shumica në pushtet dhe opozita kanë bashkëpunuar për të miratuar një numër të instrumenteve ligjore në parlament. Kjo përfshin miratimin e Ligjit mbi Shërbimin Civil, Ligjin mbi Gjykatën e Lartë dhe Rregulloren e punës së Parlamentit dhe një grup të amendamenteve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Civile.

Ndonëse procesi që dërgoi në zgjedhjet parlamentare të 23 të qershorit u shënuar me tensione, duke rrezikuar kohë pas kohe punën e organeve të administratës zgjedhore, zgjedhjet ishin konkurruese dhe u zhvilluan në përgjithësi në mënyrë të rregullt, me një pjesëmarrje të lartë të votuesve. Shqipëria ka bërë përparim të mëtejshëm në lidhje me reformën e administratës publike, në veçanti përmes miratimit të Ligjit mbi Shërbimin Civil.

Janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për reformimin e gjyqësorit, përfshirë edhe riorganizimin e sistemit të gjykatave. Metodatat e përmirësuar të punës së organeve anti-korrupsion, rritja e dënimeve dhe bashkëpunimi më i mirë ndër-institucional rezultoi në një progres në luftën kundër korrupsionit, duke siguruar një regjistër të rezultateve, i cili duhet të forcohet. Monitorimi më i mirë dhe transparenca në fushat kyçe, siç janë regjistrimi i pronës, doganat,

arsimi i lartë dhe shëndetësia, dëshmojnë për rritjen preventive të ndërgjegjësimit. Janë adresuar rekomandimet e Këshilli të Evropës mbi financimin e partive politike dhe dispozitat ligjore mbi korrupsionin. Megjithatë, korrupsioni mbetet një problem veçanërisht serioz i cili kërkon vendosmëri dhe përpjekje të përbashkëta për t'u adresuar. Sa i përket krimit të organizuar, është përmirësuar bashkëpunimi policor ndërkombëtar, sikurse është përmirësuar analiza e rrezeve; janë rritur konfiskimet e narkotikeve dhe aseteve kriminale. Rekomandimet e Këshillit të Evropës në luftën kundër pastrimit të parave janë përmbushur. Ndryshimet e rëndësishme të Kodit Penal trajtojnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimet tjera të rënda.

Në fushën e të drejtave të njeriut, përgjithësisht është respektuar liria e tubimit dhe e organizimit, si dhe liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit. Është bërë progres në fushën e anti-diskriminimit, për shembull nëpërmjet planit të veprimit për të drejtat e personave të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI). Në fushën e lirisë së shprehjes, Ligji mbi Mediat Audio-Vizuale ndjeshëm ka përmirësuar kornizën legjislative për mediat audio-vizuale në Shqipëri.

Në perspektivë, Shqipëria ka nevojë të përshpejtojë reformën e gjyqësorit. Aranzhimi institucional dhe ligjorë i gjyqësorit duhet të rishikohet dhe të forcohet. Për të siguruar pavarësinë, transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e gjyqësorit mbetet të finalizohet ose miratohet legjislacioni themelor, duke përfshirë ndryshimet kushtetuese për të depolitizuar emërimet në Gjykatën e Lartë. Legjislacioni i miratuar kohët e fundit duhet të zbatohet në mënyrë efektive me mbështetjen e plotë të politikanëve dhe profesionistëve gjyqësor.

Për më tepër, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të reformës së administratës publike, në veçanti në lidhje me ligjet strukturore dhe aktet administrative. Legjislacioni sekondar në Ligjin e ri mbi Shërbimin Civil duhet të miratohet dhe të zbatohet me shpejtësi. Duhet të sigurohet vazhdimësia në administratën publike dhe duhet të shtohet profesionalizmi, de-politizimi dhe llogaridhënia.

Do të jenë të domosdoshme masa të synuara në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe përmes fuqizimit të një organi qendror koordinues me autoritet dhe kapacitete të nevojshme si dhe me mbështetje të fortë politike. Duhet të shtohet kapaciteti i parandalues dhe represivë dhe pavarësia e institucioneve të zbatimit të ligjit. Duhet të sigurohet përcjellja adekuate e raporteve të institucioneve të pavarura nga parlamenti.

Gjithashtu duhet zhvilluar më tej regjistri i hetimeve efektive dhe ndjekjet penale të krimit të organizuar, duke ndërtuar mbi rezultatet fillestare. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përfunduar ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe për të zgjeruar në mënyrë efektive përdorimin e vlerësimit të rrezikut, shkëmbimin e inteligjencës dhe hetimet e synuara proaktive. Nevojitet një qasje më proaktive për sa i përket hetimit të pasurisë së pasqaruar dhe dyshimet për pastrim parash.

Në fushën e të drejtave të njeriut, hartimi i legjislacionit të ri dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues duhet të jenë prioritete, me një fokus të qartë mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve dhe përfshirja e romëve. Sa i përket lirisë së shprehjes, nevojiten përpjekje shtesë për të garantuar plotësisht pavarësinë e autoritetit rregullator të medias.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria ka bërë një progres të mëtejshëm drejt shndërrimit të saj në një ekonomi funksionale të tregut. Shqipëria duhet të jetë në gjendje që të përballet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në një periudhë afatmesme, me kusht që ajo të përshpejton reformat strukturore.

Shqipëria ka ruajtur stabilitetin makroekonomik. Rritja e BPV-së është ngadalësuar, por ka mbetur kryesisht pozitive për shkak të kërkesës së jashtme. Inflacioni i ulët ka krijuar hapësirë për politikën monetare të lehtësoj nxitjen e zhvillimit, por transmissioni i saj në ekonominë reale mbetet për t'u parë, pasi rritja e kredisë u ngadalësua në mes kredive të këqija të larta dhe atyre në rritje. Deficiti buxhetor mbetet i lart dhe borxhi publik është rritur edhe më tej, duke bërë që

kufiri i borxhit statusor prej 60% të BPV-së të shkelet dhe të shfuqizohet. Ka pasur një përmirësim të lehtë në tregun e punës, por papunësia mbetet e lartë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse është ngushtuar por ende mbetet i madh. Ekonomia mbetet e rrezikuar si prej dobësive të brendshme strukturore ashtu edhe nga paqëndrueshmëria globale ekonomike.

Shqipëria ka nevojë të plotësojë politikat fiskale dhe monetare të orientuara nga stabiliteti me reformat strukturale për të siguruar zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm ekonomik. Shqipëria duhet të adresoj nivelet e larta të deficitit buxhetor dhe borxhin publik dhe ndikimin e tij afatshkurtër. Për më tepër, ajo duhet të përmirësojë parashikueshmërinë fiskale duke ulur mbivlerësimin e përsëritur të të ardhurave dhe duke mbledhur taksat në mënyrë më efikase. Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe investimeve është thelbësorë për zgjerimin e ekonomisë dhe fuqizimin e potencialit të saj afatgjatë të zhvillimit. Kjo mund ndër të tjera të arrihet, duke përforcuar sundimin e ligjit, trajtimin e korrupsionit dhe adresimin e vonesave të pagesave, si dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapitalit njerëzor. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) vazhdoi përgjithësisht të zbatohet pa probleme dhe Shqipëria vazhdoi përafrimin e legjislacionit e saj me kërkesat e legjislacionit të BE-së në një numër fushash, duke rritur **aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**. Përmirësime janë bërë në fushat siç janë prokurimi publik, statistikat, drejtësia, liria dhe siguria si dhe doganat. Shqipëria duhet të bëjë përpjekje shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, dhe t'i kushtoj vëmendje të veçantë sektorit të energjisë, duke përfshirë zgjerimin e burimeve të energjisë, funksionimin e tregut të energjisë elektrike, adresimin e shqetësimeve mbi humbjet e rrjetit dhe normat e ulëta të inkasimit. Nevojitet gjithashtu që Shqipëria të adresojë me vendosmëri çështjen e rimbursimit të TVSH-së, duke përfshirë rastet ekzistuese të pazgjidhura, dhe të përforcojë mbrojtjen e mjedisit përfshirë edhe përmes investimeve të qëndrueshme në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave të zeza. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në fushat e punësimit dhe politikës sociale. Duhet të forcohet kapaciteti administrativ dhe profesionalizmi i organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis-it* si dhe të mbrohet pavarësia e organeve rregullatore. Në disa fusha të *acquis-it*, në veçanti në prokurimin publik dhe kontrollin financiar, është e rëndësishme që të rritet transparenca dhe llogaridhënia.

## **Bosnja dhe Hercegovina**

Bosnja dhe Hercegovina është në një situatë pezull në procesin e integritimit Evropian, ndërsa vendet e tjera në rajon po lëvizin përpara. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) u nënshkrua në vitin 2008 dhe procesi i ratifikimit u përfundua në vitin 2011. MSA-ja nuk ka hyrë ende në fuqi, sepse vendi nuk ka plotësuar kërkesat e mbetura, sidomos një përpjekje të besueshme në zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Sejdiç- Finci lidhur me diskriminimin ndaj qytetarëve mbi baza të përkatësisë etnike. Prandaj, marrëdhëniet e BE-së me Bosnjë dhe Hercegovinën ende zhvillohen sipas Marrëveshjes së Përkohshme (MP) të vitit 2008.

Përfaqësuesit politikë nuk kanë një vizion të përbashkët përkitazi me drejtimin e përgjithshëm dhe të ardhmen e vendit, ose se si duhet të funksionojë ajo. Nuk ka asnjë dialog të hollësishëm të brendshëm politik në çështjet themelore siç janë procesi i integritimit në BE dhe as ndonjë aranzhim prioriteti përkitazi me këtë. Agjenda e BE-së nuk është prioritet për përfaqësuesit politikë të vendit dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë progres në perspektivën evropiane të Bosnjës dhe Hercegovinës. Interesat afatshkurtra partiake apo etnike po mbizotërojnë mbi një politikë të orientuar kah e ardhmja që është ankorimi i Bosnjës dhe Hercegovinës në BE. Bllokada politike në Federatë, e cila është duke vazhduar për më shumë se një vit, ka një ndikim negativ në qeverisje si në nivel Federativ ashtu edhe në nivel shtetëror. Disa nga akterët politikë vazhdimisht e vënë në pikëpyetje unitetin e Bosnje dhe Hercegovinës si një shtet i vetëm.

Nuk janë përmbushur dy zotimet kyçe në Udhërrëfyesin e vitit 2012 mbi aplikimin e vendit për

anëtarësim në BE, sidomos zbatimi aktual i aktgjykimit Sejdiç-Finci dhe ngritja e një mekanizmi efektiv koordinues mbi çështjet e BE-së. BE-ja ka bërë përpjekje intensive lehtësuese për të ndihmuar liderët politikë të Bosnjës dhe Hercegovinës për të gjetur terren të përbashkët për zbatimin e aktgjykimit Sejdiç-Finci, por ata nuk mund të bien dakord për një zgjidhje.

Adresimi i këtij aktgjykimi nuk është vetëm vendimtar për vendin që të avancojë në rrugën e BE-së, por edhe për legjitimitetin dhe besueshmërinë e Presidencës dhe të Dhomës së Popujve të Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilat do të zgjidhen në vitin 2014. Kjo do të zhbllokojë procesin e anëtarësimit në BE, i cili është jetikë për evoluimin e Bosnjë-Hercegovinës dhe e saj nga një vend i pasluftës në të qenit Shtet Anëtar i BE-së në të ardhmen. Pa guxim politik dhe vendosmëri, perspektiva evropiane e Bosnjës dhe Hercegovinës nuk do të materializohet.

Njësoj urgjente dhe e rëndësishme është krijimi i një mekanizmi koordinues mbi çështjet e BE-së në mes të niveleve të ndryshme të qeverisë. Në një vend shumë të decentralizuar si Bosnja dhe Hercegovina, një mekanizëm i tillë është i një rëndësie thelbësore në mënyrë që përfaqësuesi përkatës nga Bosnja dhe Hercegovina të jetë në gjendje të flas në emër të të gjithë vendit dhe të zotohet kur të bashkëveprojë me BE-në. I përket vetë Bosnjë Hercegovinës që të zhvillojë urgjentisht një mekanizëm që i përmbahet kësaj kërkesë themelore.

Po bëhet gjithnjë e më vështirë të justifikohet dhënia e fondeve të para-anëtarësimit për një vend përfaqësues politik të të cilit nuk janë të gatshëm të arrijnë konsensusin e nevojshëm për të ecur përpara në rrugën e para-anëtarësimit. Pa këtë konsensus, ekziston një rrezik i madh se ndihma e para-anëtarësimit nuk do të prodhojë rezultate të pritura. Duke pasur parasysh se asnjë zgjidhje nuk është gjetur ende në zbatimin e aktvendimit Sejdiç-Finci dhe mekanizmi koordinues me BE-në nuk është themeluar, nuk mund të mbahet nivel i njëjtë i financimit në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Komisioni ka vendosur të shtyjë diskutimet e mëtejshme mbi IPA II derisa vendi të kthehet në rrugën e duhur në procesin e integritetit në BE. Në mungesë të progresit të dukshëm, Bosnja dhe Hercegovina rrezikon të humbë fonde të konsiderueshme të para-anëtarësimit.

Përgatitjet e vendit për t'iu përshtatur pranimit të Kroacisë kanë qenë të ngadalshme por marrëveshjet e nevojshme që kanë të bëjnë me kalimin e personave dhe mallrave në kufi me Kroacinë u nënshkruan me kohë para 1 korrikut. Komisioni konstaton se është e papranueshme që Bosnja dhe Hercegovina deri më tani ka refuzuar të adaptoj MP/MSA-në që të merr parasysh tregtinë e saj tradicionale me Kroacinë. Komisioni i bën thirrje Bosnjës dhe Hercegovinës që urgjentisht të rishikojë pozicionin e saj në mënyrë që të mund të finalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur një adaptim në bazë të rrjedhave tradicionale të tregtisë.

Vendi ka bërë progres shumë të kufizuar në adresimin e **kritereve politike**. Duke mos e zbatuar aktvendimin Sejdiç-Finci, vendi ende nuk i ka dhënë fund praktikës diskriminuese me ç'rast qytetarët e Bosnjë dhe Hercegovina që nuk e deklarojnë veten se i përkasin njërit prej tre popujve përbërës janë të privuar nga e drejta për të kandiduar për president dhe/ose për Dhomën e Popujve të Bosnjës dhe Hercegovinës. Proceset legislative në përgjithësi mbeten jashtëzakonisht të ngadalshme, për shkak të mungesës së vullnetit politik për të arritur kompromis. Përdorimi i shpeshtë i procedurës urgjente për të paraqitur ligje në Asamblenë Parlamentare të Bosnjë dhe Hercegovinës rezultoi në një përdorim të gjerë të procedurave me Interes Thelbësor Kombëtar. Për shkak të mungesës së marrëveshjes politike, legjislacioni është bllokuar shpesh duke përdorur veton e Entitetit.

Ende është një nivel të lartë i korrupsionit, mungojnë masat efektive parandaluese kundër pastrimit të parave dhe është bërë përparim i kufizuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Pasi që ka pasur progres të kufizuar në reformën e përgjithshme të sistemit gjyqësor, janë duke u zbatuar një numër i rekomandimeve të lëshuara nga Komisioni mbi kornizën e Dialogut të Strukturuar për Drejtësi: në fushën e procedimit të krimeve të luftës vendosmëria e juridiksionit për rastet ka përparuar në mënyrë domethënëse në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Krime të Luftës dhe alokimit adekuat të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore nga buxhetet përkatëse dhe kontributet e mëdha nga IPA. Numri i rasteve të

pazgjidhura është reduktuar. Është premtuese lidhja e Protokolleve për Bashkëpunim në Ndjekjen Penale të Kryerësve të Krimeve të Luftës, Krimeve kundër Njerëzimit dhe Gjenocidit si me Kroacisë ashtu dhe me Serbinë. Në përgjithësi, ka ende mangësi serioze sa i përket pavarësisë, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit në Bosnje dhe Hercegovinë.

Mbetet i kufizuar zbatimi i instrumenteve ekzistuese të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe ato të mbrojtjes së personave si lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transeksualëve dhe interseksualve (LGBTI) nga dhuna dhe gjuha e urrejtjes si dhe zbatimi i planeve të veprimit për romët. Boshllëqet legjislativë ende pengojnë kthimin e qëndrueshëm dhe integrimin lokal të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit. Ekzistojnë dispozitat ligjore që garantojnë lirinë e shprehjes, por megjithatë frikësimi i gazetarëve dhe redaktorëve mbetet ende një çështje shqetësuese sikurse edhe presionet financiare në transmetuesit publik. Bosnja dhe Hercegovina ka vazhduar të marrë pjesë aktivisht në bashkëpunimin rajonal dhe të mbajë marrëdhënie të mira fqinjësore. Çështjet e mbetura të pronësisë dhe të kufirit me vendet fqinje duhet të adresohen.

Përgatitjet e hollësishme në të gjitha nivelet të mbështetura nga BE-ja dhe organizatat tjera ndërkombëtare, e kanë bërë të mundur kryerjen regjistrimit të popullsisë që është pritur një kohë të gjatë në Bosnje dhe Hercegovinë, i pari që nga viti 1991.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë një përparim të vogël të mëtejshëm drejt një ekonomie funksionale të tregut. Nevojitet që të vazhdohen me vendosmëri dhe përpjekje të mëtejshme të konsiderueshme për të mundësuar që vendi për një periudhë afatgjatë të përballet me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Ekonomia është tkurrur për 1.1% në vitin 2012. Megjithatë, treguesit për gjysmën e parë të vitit 2013 tregojnë disa shenja të rimëkëmbjes. Papunësia është ende shumë e lartë. Cilësia e financave publike mbetet e ulët, edhe pse menaxhimi i financave publike është forcuar disi. Pavarësisht disa përmirësimeve të vogla, konsensusi mbi bazat e politikave ekonomike dhe fiskale mbetet i dobët, duke penguar kështu reformat në nivel vendi. Sektori i madh dhe joefikas publik me kompetenca të shumta të duplikuara në nivel shtetëror, entiteti dhe në nivel kantonal ose komunal (veçanërisht në Federatë) vazhdon të paraqet rrezik për qëndrueshmërinë fiskale. Një sistem joefikas ligjor dhe gjyqësor pengon kapacitetin e zbatimit dhe është një frenues i qartë për investim si dhe një burim i korrupsionit.

Përbërja dhe efikasiteti i ulët i shpenzimeve publike në Bosnje dhe Hercegovinë mbetet një shqetësim. Në këtë kontekst, duhet të përmirësohet më tej raportimi fiskal në mënyrë që të rrisë cilësinë e analizës dhe hartimin e politikave. Ngurtësisë strukturore siç janë tatueshmëria e tepruar i punës dhe transferimet sociale të synuara në mënyrë të dobët do të kërkojnë masa për të nxitur kërkesën për fuqi punëtore. Autoritetet në Federatë duhet të vazhdojnë me zhvillimin e reformës së pensioneve. Duke pasur parasysh hisen e lartë të kompanive publike në ekonomi, autoritetet duhet të riaktivizojnë privatizimin, i cili ka potencial për të përmirësuar situatën fiskale dhe të sjellë më shumë konkurrencë. Sektori privat duhet të mbështetet nga një mjedis i shëndoshë biznesi, më së shumti duke përmirësuar zbatimin e kontratave dhe krijimin e një hapësire të vetme ekonomike në vend. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Mungesa e mbështetjes të mirëfilltë politike për agjendën e BE-së është pasqyruar në progresin shumë të kufizuar edhe sa i përket **përafrimit me ligjet dhe standardet e BE-së**. Këto shqetësime janë në veçanti për fushat e veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit; konkurrencës; prokurimin publik, energjisë, ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit; transportit; politikat sociale dhe të punësimit. Në fushat tjera, siç janë zhvillimi rural apo politika rajonale, ka pak progres për shkak të mungesës së marrëveshjes mbi strategjitë përkatëse për mbarë vendin. Në një numër të rasteve duhet të bëhen emërimet për organe të rëndësishme. Dështimi për të bërë këtë po e pengon përparimin e legjislativës. Institucionet tjera siç është Këshilli për Ndihmë Shtetërore po pëson nga mungesa e burimeve financiare dhe për këtë arsye nuk ka mundur të funksionojë siç duhet deri më tani. Një nga përjashtimet e pakta pozitive është në fushën e të

drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare ku janë avancuar përgatitjet për t'u përfaruar me standardet e BE-së.

Në mënyrë që Bosnja dhe Hercegovina të jetë në gjendje të eksportojë produktet me origjinë shtazore në BE është e nevojshme të avancojë me shpejtësi transpozimin e legjislacionit veterinar dhe të sigurisë së ushqimit të BE-së. Bosnja dhe Hercegovina është vendi i vetëm në rajon që nuk e ka përafuar legjislacionin e saj me direktivat e BE-së të vitit 2004 mbi prokurimin publik. Nevojitet që BeH ta bënë këtë si një çështje urgjente. Vendi duhet të mbaj përpjekjet e vazhdueshme për zbatimin e qëndrueshëm të të gjitha reformave të parashtruara në udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, si edhe masave më të gjëra në kufij që synojnë forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale. Duhet të vazhdojnë aktivitetet përkitazi me parandalimin e abuzimeve të regjimit pa-viza.

## **Kosova**

Viti 2013 ka qenë një vit historik për Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Vendimet e Këshillit në qershor që autorizuan hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) paraqet fillimin e një faze të re të rëndësishme në marrëdhëniet BE-Kosovë. Negociatat do të hapen zyrtarisht këtë muaj. Komisioni ka për qëllim të përfundojë këto negociata në pranverë të vitit 2014, të iniciojë një draft marrëveshje në verë dhe më pas të parashtojë propozimet për Këshillin për të nënshkruar dhe lidhur marrëveshjen.

Kosova ka punuar në mënyrë aktive dhe konstruktive në përmirësim e dukshëm dhe të qëndrueshëm të *marrëdhënieve me Serbinë*. Në prill, angazhimi i Kosovës në dialogun e lehtësuar nga BE-ja rezultoi në "*Marrëveshjen e parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve*" me Serbinë (Marrëveshja e parë), e cila u plotësua në maj nga plani zbatues. Të dy palët në veçanti kanë rënë dakord që asnjëra palë nuk do të bllokojë ose të inkurajojë të tjerët për të bllokuar progresin e palës tjetër në rrugët e tyre përkatëse për në BE. Kjo paraqet një ndryshim rrënjësor në marrëdhëniet midis të dy palëve. Zbatimi i Marrëveshjes së Parë ka vazhduar dhe tashmë ka dërguar në një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren. Palët kanë arritur marrëveshje mbi energjinë dhe telekomunikacionin. Ka pasur gjithashtu progres në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun teknik, me mbështetjen e misionit të BE-së për sundimit e ligjit - EULEX. Kosova duhet të mbetet e angazhuar plotësisht për normalizimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog. Kosova duhet të përfundojë zbatimin e Marrëveshjes së Parë në veçanti për policinë, drejtësinë dhe zgjedhjet komunale.

Marrëveshja e parë ka hasur në rezistencë në *veri të Kosovës*. Përmbajtja e Prishtinës dhe qasja gjithëpërfshirëse, se bashku me rolin pozitiv të luajtur nga Beogradi, e ka penguar eskalimin e situatës. Pas Marrëveshjes së Parë, janë mbyllur stacionet policore serbe që veprojnë në veri të Kosovës; janë ndërprerë pagesat e rrogave nga Serbia për nëpunësit e policisë të punësuar nga Kosova; Gjykatat serbe kanë ndërprerë procedimin e rasteve kriminale në Kosovë; dhe janë shpërbërë kuvendet komunale të katër komunave veriore. Zgjedhjet komunale të planifikuara për muajin nëntor do të mbahen edhe në pjesën veriore të Kosovës. Është e rëndësishme që këto zgjedhje të mbahen në mënyrë të rregullt dhe të gjithë njerëzit me të drejtë vote të marrin pjesë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike. Më 19 shtator, një pjesëtar i EULEX-it u vra në një sulm mbi një konvoj të EULEX-it në veri të Kosovës. Si udhëheqja e Kosovës ashtu edhe ajo e Serbisë dënoi sulmin me shprehjet më të forta.

Kosova ka përfunduar *reforma* të rëndësishme të politikave. Në prill, Komisioni dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për politika të Punëve të Jashtme dhe Siguri konfirmoi<sup>1</sup> se Kosova i ka përmbushur prioritetet afatshkurtra mbi sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe të tregtisë siç janë identifikuar në studimin<sup>2</sup> e fizibilitetit në tetor të vitit të

<sup>1</sup> JOIN (2013) 8 përfundimtare

<sup>2</sup> COM (2012) 602 përfundimtare

kaluar. Në prill, Komisioni gjithashtu lëshoi rekomandimin e tij për Këshillin për të nënshkruar dhe lidhur një marrëveshje kornizë që i mundëson Kosovës të merr pjesë në programet e Bashkimit Evropian.

Në dhjetor, Kosova u bë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Në qershor, Kosova nënshkroi një marrëveshje kornizë me Bankën Evropiane të Investimeve dhe Këshillin e Bankës Evropiane për Zhvillim dhe u dakorduan që Kosova të anëtarësohet në këto institucione. Në shkurt, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal vendosi të ndryshojë statutin e tij për të lejuar që Kosova të bëhet pjesëmarrëse me të drejtat e veta.

Dialogu për *liberalizimin e vizave* ka mbetur shumë lartë në agjendën politike të Kosovës. Prishtina ka bërë përpjekje për të siguruar përparimin. Në shkurt, Komisioni miratoi raportin e tij të parë mbi përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit<sup>3</sup> për liberalizimin e vizave nga ana e Kosovës. Kosova miratoi planin e saj të veprimit për liberalizimin e vizave në prill. Deri më tani, janë mbajtur tri takime të zyrtarëve të lartë. Në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Zyrën e BE-së në Prishtinë dhe EULEX-in, Kosova ka bërë përparim në ndryshimin e legjislacionit siç rekomandohet në raport. Në këtë drejtim nevojiten përpjekje të mëtejshme. Gjithashtu Kosova duhet të përqendrohen në zbatimin e legjislacionit.

Konsensusi i gjerë politik për perspektivën evropiane të Kosovës ishte i vlefshëm për momentumin e procesit të përafrimit. Gjithashtu edhe Këshilli Kombëtar për Integritet Evropian e ka ndjekur këtë objektiv. Është e rëndësishme që ky konsensus të ruhet dhe të zgjerohet më tej. Këto përpjekje duhet të vërtetojnë kontributin kyç për negociatat mbi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit.

Studimi i fizibilitetit i Komisionit përcakton fushat prioritare në të cilat Kosova duhet të përqendrohet për të përmbushur obligimet e veta sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit. Këto janë sundimi i ligjit, gjyqësori, administrata publike, reforma zgjedhore dhe Kuvendi, të drejtat themelore të njeriut, mbrojtja e minoriteteve, dhe çështjet e tregut dhe tregtisë së brendshme, si dhe çështjet fito-sanitare dhe veterinare.

Në kontekstin e **kritereve politike**, qeveria e Kosovës ka rritur kapacitetin e saj për të adresuar prioritetet e procesit të integritet evropian. Ajo ka demonstruar këtë kapacitet me ndjekjen e prioritetëve afatshkurtra të studimit të fizibilitetit dhe përgatitjet për negociatat e Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit. Gjithashtu janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar mbikëqyrjen e punës së qeverisë nga Kuvendi. Megjithatë, vendimi i Kuvendit për të debatuar rezultatin e një lënde të gjyqësorit ishte një ngecje në përpjekjet e Kosovës për të forcuar institucionet e veta të qeverisjes demokratike.

Kosova ka demonstruar një angazhim për të dhënë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë nisjen e hetimeve dhe forcimin e kornizës legjislative. Janë ndërmarrë hapat e parë për të prodhuar statistika të harmonizuara në këtë fushë. Kosova gjithashtu ka vazhduar edhe bashkëpunimin e saj të mirë me EULEX-in. Sistemi gjyqësor ka pësuar reformë të rëndësishme. Zbatimi koherent i tij do të jetë thelbësor për të sjellë ndryshime të mëtejshme pozitive dhe do të duhet të monitorohet nga afër. Në janar, ligjet për gjykatat dhe prokurorinë kanë hyrë në fuqi, duke prezantuar struktura të reja gjyqësore dhe prokuroriale. Korniza e re ligjore pritet të kontribuojë në pavarësinë, efektivitetin, përgjegjshmërinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Kosova gjithashtu ka vazhduar ripranimin e personave nga Shtetet Anëtare.

Pas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit, Kuvendi i ka modifikuar nenet e Kodit Penal mbi përgjegjësinë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarëve.

---

<sup>3</sup> COM (2013) 66 përfundimtare

Këshilli i Monitorimit të Zbatimit i cili bashkon autoritetet e Kosovës dhe Kishën Ortodokse Serbe është themeluar dhe po funksionon mirë. Ka filluar gjithashtu transmetimi publik në gjuhën serbe. Është emërua një Komisioner Gjuhësor i ri dhe zyra e tij ka filluar të kryejë funksionet e veta. Buxheti dhe stafi i Avokatit të Popullit janë rritur në mënyrë që ky institucion tani mund të performojë në rolin e tij si mbrojtës i qeverisjes së mirë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.

Kosova ende duhet të sigurohet se ka përfunduar *reforma zgjedhore* dhe se korniza ligjore pasqyron praktikën më të mirë të BE-së. *Kuvendi* duhet të rrisë mbikëqyrjen e tij ndaj ekzekutivit duke përmirësuar kontrollin e draft legjislacionit dhe duke monitoruar zbatimin e politikave dhe ligjeve. Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrje adekuate në punën e Kuvendit. Është përmirësuar pavarësia financiare e Kuvendit, por janë të nevojshëm hapa të mëtejshëm (për shembull përmirësimin e rregullave të punës dhe legjislacionit të Kuvendit) për të rritur pavarësinë financiare dhe administrative të Kuvendit.

Në *sundimin e ligjit*, Kosova duhet të ofrojë dëshmi konkrete të rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si një çështje prioritare, si dhe forcimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij. Kosova duhet të përmirësojë më tej besueshmërinë e statistikave në këto fusha. Kosova duhet aktivisht të mbështes EULEX-in në zbatimin e mandatit të tij, duke përfshirë edhe Task Forcën Speciale Hetuese. Kosova në mënyrë progresive është duke i marrë përsipër përgjegjësit shtesë nga EULEX-i. Dialog i strukturuar mbi Sundimin e Ligjit është një forum thelbësor për Kosovën dhe BE-në për të shqyrtuar progresin në këtë drejtim.

Ndërhyrja politike në punën e *gjyqësorit* mbetet një shqetësim serioz. Këshillat Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të reagojnë ashpër ndaj sulmeve kundër gjyqtarëve, prokurorëve dhe institucioneve gjyqësore. Kuvendi dhe qeveria duhet të bëjë të njëjtën gjë. Nevojiten masa adekuate të sigurisë dhe mbrojtjes për gjyqtarët dhe personelin e gjykatave, si dhe prokurorëve, dëshmitarëve dhe paditësve. Kosova duhet të marrë masa të mëtejshme për të reduktuar totalin e lëndëve të pazgjidhura, përfshirë edhe zbatimin e vendimeve të gjykatës, dhe të sigurojë që gjykimet të mbahen në ambiente të përshtatshme dhe në përputhje me procedurat gjyqësore. Duhet të vazhdojë rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga pakicat në përputhje me kornizën legjislative. Kosova duhet të sigurohet që prokuroria speciale përgjegjëse për rastet e krimit të organizuar, krimet e luftës dhe korrupsionit të mbajë kompetencat e saj.

Sa i përket *administratës publike*, Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit, strategjisë dhe planit të veprimit, i cili kërkon udhëheqje të fortë politike. Duhet të përmirësohet profesionalizmi i shërbimit civil dhe personat që i përkasin pakicave duhet të jenë të përfaqësuar mirë në përputhje me legjislacionin. Duhet të ndalet ndërhyrja politike në rekrutim dhe emërim të punonjësve publikë. Në fushën e të drejtave themelore të njeriut, duhet të thjeshtohet aranzhimi kompleks dhe duplikues institucional për promovimin dhe mbrojtjen e tyre. Nevojiten më shumë përpjekje në hetimin dhe ndjekjen penale të sulmeve fizike kundër gazetarëve. E njëjta gjë vlen edhe për incidentet e dhunshme kundër komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI). Nevojitet gjithashtu progres në zbatimin e të drejtave pronësore, për shembull, përmes zvogëlimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe përmirësimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative. Legjislacioni duhet të zbatohet më mirë tek mbrojtja e të dhënave personale. Kuvendi duhet të hartojë një mekanizëm të qëndrueshëm afatgjatë të financimit për transmetuesin publik; emërimet për bordin e tij ende duhet të përfundohen.

Sa i përket *mbrojtjes së minoriteteve*, duhet të zbatohet legjislacioni mbi trashëgiminë kulturore dhe Kishën Ortodokse Serbe. Autoritetet lokale duhet të mbështeten më tej për të vazhduar procesin e decentralizimit. Duhet të zbatohen në mënyrë energjike strategjia dhe plani i veprimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, pasi që gjendja e këtyre pakicave në terren mbetet një shqetësim i madh. Kjo është gjithashtu e rëndësishme në kontekstin e procesit të liberalizimit të vizave. Sulmet motivuara nga përkatësia etnike apo fetare duhet të hetohen, ndiqen penalisht dhe autorët të sillen para drejtësisë.



Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova ka bërë progres drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Nevojiten reforma dhe investime të konsiderueshme për t'i mundësuar Kosovës të përballojë në një periudhë afatgjatë presionin konkurrues dhe forcat e tregut.

Situata sfiduese ekonomike në rajon dhe në BE ka filluar të ndikojë në ekonominë e Kosovës, edhe pse më pak sesa në vendet e tjera të rajonit. BPV-ja e Kosovës u rrit për 2.5% në vitin 2012. Politika fiskale ka qenë e kujdesshme dhe performanca e buxhetit ka qenë në rrugën e duhur. U prezantua një rregull fiskale ligjërishit e detyrueshme, për t'u zbatuar në vitin 2014. Papunësia ka mbetur shumë e lartë. Kosova ka vazhduar investime të konsiderueshme në infrastrukturën e saj.

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur stabilitetin makroekonomik dhe përmirësimin e situatës sociale. Kosova ka nevojë që të përmirësojë konkurrencën dhe mjedisin e saj të biznesit, dhe të mbështesë sektorin privat në mënyrë që të zvogëlojë papunësinë. Një mjedis i shëndoshë biznesi kërkon masa të mëtejshme për të trajtuar sundimin e dobët të ligjit dhe korrupsionin. Privatizimi duhet të vazhdojë. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Duhet të trajtohen prioritetet në fushën e **standardeve evropiane** në kontekst të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimi-Asociimit. Kosova ka përfunduar ristrukturimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mënyrë që të jetë në gjendje të negociojë në mënyrë efektive pjesët e marrëveshjes që kanë të bëjnë me tregtinë dhe po ashtu ajo ka përfunduar analizën e ndikimit. Gjithashtu, Kosova ka ndërmarrë përpjekje për të përgatitur regjistrimin bujqësor.

Sa i përket *çështjeve të tregtisë dhe tregut të brendshëm*, është thelbësor përmirësimi i statistikave biznesore të Kosovës. Kosova duhet të vazhdojë zbatimin e kornizës ligjore për tregtinë, konkurrencën, dhe tregun e brendshëm. Kosova duhet të rrisë përpjekjet e saj në një numër *fushash fito-sanitare dhe veterinare* që ndikojnë në sigurinë e ushqimit, siç është përcaktuar në studimin e fizibilitetit. Në sektorin e *energjisë*, duhet të shtohen përpjekjet për mbylljen e termocentralit Kosova A. Të përqendruarit në prioritetet e studimit të fizibilitetit, në përgatitjen e negociatave të marrëveshjes me BE-në dhe për dialogun e liberalizimit të vizave ka pasur një ndikim në avancimin e sektorëve tjerë.

## **Turqia**

Turqia është një vend kandidat dhe një partner strategjik për Bashkimin Evropian. Turqia, me ekonominë e saj të madhe, dinamike, është një partner i rëndësishëm tregtar për BE-në dhe një komponent e vlefshme e konkurrencës së BE-së nëpërmjet Bashkimit Doganor. Turqia ka një lokacion strategjik, duke përfshirë sigurinë e energjisë, si dhe luan një rol të rëndësishëm rajonal. Komisioni nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe dialogun për çështjet e politikës së jashtme. Njësoj, BE-ja mbetet një mbështetëse e rëndësishme për reformat ekonomike dhe politike të Turqisë. Ngjarjet e Gezi Parkut e kanë theksuar rëndësinë e promovimit të dialogut më të gjerë në të gjithë spektrin politik dhe shoqëror dhe nevojën për respektimin e të drejtave themelore në praktikë.

Agjenda Pozitive, e lansuar në vitin 2012, vazhdon të mbështesë dhe plotësojë negociatat e aderimit me Turqinë përmes bashkëpunimit të shtuar në një numër fushash të interesit të përbashkët. Ndonëse agjenda ka dhënë disa rezultate pozitive, ajo nuk është një zëvendësim për negociatën. Potenciali i plotë i marrëdhënieve BE-Turqi është më së miri i plotësuar në kuadër të kornizës së procesit aktiv dhe të besueshëm të anëtarësimit. Ky proces mbetet korniza më e përshtatshme për promovimin e reformave që kanë të bëjnë me BE-në, zhvillimin e dialogut mbi çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, forcimin e aftësisë konkurruese ekonomike dhe rritjen e bashkëpunimit në fushën e energjisë dhe të drejtësisë si dhe të punëve të brendshme. Nevojitet që negociatat e anëtarësimit të rimarrin momentumin, duke respektuar angazhimet e BE-së dhe kushtëzimet parashtruara. Në këtë drejtim, hapja e kapitullit 22 - Politikë rajonale, pas më shumë se tre vjet ngecjeje në negociatën, paraqet një hap të rëndësishëm. Turqia mund të përshpejtojë ritmin e negociatave me përmbushjen e standardeve, plotësimin e kërkesave të

Kornizës Negociuese dhe duke respektuar detyrimet e veta kontraktuale ndaj BE-së, përfshirë edhe zbatimin e plotë dhe jo-diskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit ndaj të gjitha Shteteve Anëtare.

Sipas **kritereve politike** është shfaqur një pamje e përzier nga zhvillimet gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit në Turqi. Përpjekjet për reforma të rëndësishme kanë vazhduar. Katërt pakot e reformës së gjyqësorit të miratuara në prill forcuan mbrojtjen e të drejtave themelore, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe luftës kundër mosndëshkimit për rastet e torturës dhe keqtrajtimit. Qeveria ka filluar një proces paqeje që ka qëllim t'i jap fund terrorizmit dhe dhunës në juglindje të vendit dhe të hapë rrugën për një zgjidhje të çështjes kurde. Ky proces duhet të ndiqet me mirëbesim në të gjitha anët. Masat shpallura në paketën e demokratizimit të paraqitura në shtator të vitit 2013 parashohin reforma të mëtejshme për një sërë çështjesh të rëndësishme, duke përfshirë përdorimin e gjuhëve të tjera përveç gjuhës turke, të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve dhe ndryshime në pragjet e tanishme të larta të përfaqësimit në parlament si dhe financimin e partive politik, që duhet të rris pluralizmin. Është kyç progresi i bashkëpunimit me partitë opozitare dhe zbatimi në përputhje me standardet evropiane.

Komision për pajtim ndërpartiak i parlamentit, i cili u themelua për të hartuar një kushtetutë të re, e ka vazhduar punën e tij dhe ka arritur marrëveshje për një numër të neneve. Kjo punë duhet të vazhdojë në frymën e kompromisit. Me miratimin e një ligji gjithëpërfshirës për të huajt dhe mbrojtje ndërkombëtare, është ndërmarrë një hap i rëndësishëm në drejtim të mbrojtjes adekuate të azilkërkuesve. Gjithashtu, kanë vazhduar përpjekjet që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të grave, veçanërisht përmes zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e familjes dhe parandalimin e dhunës. Është themeluar Institucioni i Avokatit të Popullit dhe tashmë është duke punuar në mënyrë aktive për të përmbushur rolin e tij. Është bërë operacional dhe Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, ka më shumë debat publik mbi temat që më parë janë konsideruar si të ndjeshme, duke përfshirë edhe çështjen kurde, roli i ushtrisë, çështja armene apo të drejtat e personave, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual. Është përhapur debat demokratik, në veçanti përmes mediave sociale, dhe është gjithashtu duke u shprehur përtej politikës partiake tradicionale, përfshirë edhe përmes demonstratave. Në këtë drejtim, vala e protestave në muajin qershor është edhe rezultat i reformës së gjerë demokratike, që ka ndodhur në dekadën e kaluar dhe krijimin e një shoqërie civile vibrante dhe të larmishme që duhet të respektohet dhe të konsultohet në mënyrë më sistematike në çdo nivel të vendimmarrjes, pavarësisht se kush e mban shumicën në parlament.

Megjithatë, progresi i mëtejshëm është frenuar nga faktorë të ndryshëm të vazhdueshëm. Klima politike ende karakterizohet me polarizim dhe i mungon fryma e kompromisit. Qeveria ka tentuar të mbështetet ekskluzivisht në shumicën e saj parlamentare për të miratuar ligje dhe vendime, duke përfshirë çështjet e ndjeshme sociale, pa konsultime të mjaftueshme dhe dialog me palët e interesit. Tensionet dhe frustrimi rezultues përfundimisht arritën kulmin në maj dhe qershor rreth një projekti kontrovers të zhvillimit urban të Gezi Parkut në Stamboll dhe vërshuan në protesta të mëdha në shumë qytete të tjera. Përpjekjet për të kontaktuar protestuesit ishin të kufizuara dhe të lëna nën hije nga përdorimi i tepruar i forcës nga ana e policisë, gjuha polarizuese dhe mungesa e përgjithshme e dialogut. Si rezultat i konfrontimeve, gjashtë persona humbën jetën dhe më shumë se 8 000 u lënduan. Inspektimet e kryera nga Ministria e Punëve të Brendshme konkluduan se policia përdori forcë jo-proporcionale kundër protestuesve gjatë protestave në muajt maj dhe qershor.

Vala e protestave në muajin qershor vuri në pah një numër çështjesh që duhet të trajtohen urgjentisht. Në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës nga ana e policisë, hetimet e nisura administrative dhe gjyqësore duhet të përfundohen në përputhje me të drejtën precedente të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe përgjegjësit duhet të mbajnë llogari. Duhet të miratohet dhe zbatohet në linjë me standardet evropiane legjislativoni mbi themelimin e

komisionit për monitorimin e zyrtarëve policor si një organ i pavarur mbikëqyrës për veprat penale nga ana e policisë. Ministri i Punëve të Brendshme mori një hap të parë pozitiv me lëshimin e qarkoreve për të rregulluar sjelljen e oficerëve të policisë gjatë demonstratave. Megjithatë, korniza e përgjithshme ligjore dhe praktika për ndërhyrje të oficerëve të zbatimit të ligjit duhet të sillen në përputhje me standardet evropiane, në mënyrë që të garantohet, nën çdo rrethanë, respektimi i të drejtave të njeriut, në veçanti, e drejtën për lirinë e tubimit.

Dispozitat kyçe të kornizës ligjore turke dhe interpretimi i tyre nga anëtarët e gjyqësorit vazhdojnë të pengojnë lirinë e shprehjes, duke përfshirë lirinë e mediave. Struktura e pronësisë së mediave turke, e dominuar nga grupe të mëdha industriale e kombinuar kohë pas kohe me deklarata frikësuese të bëra nga zyrtarët e nivelit të lartë dhe paralajmërimet nga autoritetet, gjithashtu e përhap vetë-censurën në media, siç është paraqitur kur mediat kryesore dështuan të raportojë mbi protestat e qershorit. Ky mjedis ka dërguar edhe në largimin dhe dorëheqjen e gazetarëve.

Interpretimi kufizues nga gjyqësori i dispozitave ligjore për provokimin e urrejtjes publike ka dërguar në një numër dënimesh për figurat publike për vërejtjet kritike mbi fenë. Përkufizimi i paqartë në legjislacionin penal të të qenit anëtarë të një organizate të armatosur vazhdon të jetë burim i një numri të madh të arrestimeve dhe ndjekjeve penale. Mbetet të krijohet korniza ligjore në përputhshmëri me KEDNJ në çështjet e besimit dhe kundërshtimit të ndërgjegjshëm. Nevojiten përpjekje substanciale që të garantohen në mënyrë efektive të drejtat e grave, fëmijëve dhe individëve të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI). Dhuna në familje, vrasjet e rastit për shkak të nderit dhe çështja e martesave të hershme dhe të detyruara mbeten një shqetësim serioz. Turqia ka nevojë të sigurojë respektimin e plotë të të gjitha të drejtave të pronësisë, duke përfshirë edhe ato të komuniteteve jo-muslimane.

Këto mangësi duhet të adresohen dhe pakoja e katërt e reformës së gjyqësorit duhet të zbatohet në mënyrë adekuate në përputhje me standardet evropiane. Autoritetet duhet të rrisin përpjekjet për të mbrojtur të drejtat dhe liritë fundamentale në mënyrë që të gjithë qytetarët të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre pa pengesë. Masat e shpallura në pakon e demokratizimit ofrojnë perspektivën e progresit në një numër të këtyre çështjeve.

Këto çështje theksojnë rëndësinë e BE-në për të rritur angazhimin e saj me Turqinë mbi të drejtat themelore. Përparimi në negociatat e anëtarësimit dhe progresi në reformat politike në Turqi janë dy anët e së njëjtës medalje. Është në interes si të Turqisë ashtu dhe të BE-së që standardet për hapjen e *kapitujve 23 - gjyqësori dhe të drejtat themelore, dhe 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria* të dakordohen dhe t'i komunikohen Turqisë sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim të mundësisë të hapjes së negociatave nën këta dy kapituj. Kjo do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për t'u siguruar se BE-ja dhe standardet e saj të mbeten pikë referimi për reformat në Turqi.

Në kuadrin e reformave të kërkuara, procesi i përgjithshëm i vendimmarrjes, si në nivel kombëtar ashtu dhe lokal, duhet të përfshijë konsultim më të strukturuar dhe më sistematik të shoqërisë civile. Është thelbësore të reformohet mjedisi ekzistues ligjor dhe ai të bëhet më i favorshëm për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi. Për shembull, vlerësimet e ndikimit mjedisor duhet të kryhen duke respektuar plotësisht *acquis-in* e BE-së. Projektet e mëdha infrastrukturore nuk duhet të përjashtohen. Konsultimi i akterëve relevantë të shoqërisë civile në fusha të tjera të politikës gjithashtu do të inkurajohet fuqimisht.

Nënshkrimi i *marrëveshjes së ripranimit BE-Turqi dhe fillimi i njëkohshëm i dialogut të vizave* janë hapat e parë drejt liberalizimit të vizave, që mund t'i japë një vrull të ri marrëdhënieve BE-Turqi dhe do të sjellë përfitime konkrete për të dyja palët. Është e rëndësishme që këto dy procese të ecin përpara dhe që procedura e ratifikimit të marrëveshjes së ri-pranimit në Turqi të finalizohet me shpejtësi në funksion të zbatimit të saj të plotë dhe efektiv.

Sa i përket *politikës së jashtme*, Turqia ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në fqinjësinë

e saj më të gjerë, për shembull zgjerimi i aktiviteteve të saja si një donator jo-tradicionale në Bririn e Afrikës, duke mbështetur tranzicionit demokratik në Afrikën e Veriut si dhe rritjen e bashkëpunimit me dhe midis Afganistanit dhe Pakistanit. Ajo ka luajtur një rol veçanërisht të rëndësishëm në Siri, duke mbështetur zhvillimin e një opozite më të unifikuar dhe ofrimin e ndihmës vitale humanitare për një numër të madh të sirianëve që largoheshin nga vendi i tyre. Turqia gjithashtu ka vazhduar të ofrojë mbështetje praktike për bisedimet E3+3 me Iranin. Ratifikimi i një marrëveshje ndërqeveritare mbi Projektin e Gazsjellësit Trans Anatoli (TANAP) midis Turqisë dhe Azerbajxhanit ishte një kontribut i rëndësishëm me qëllim të promovimit të sigurisë më të madhe energjetike evropiane përmes korridorit jugor të energjisë. Dialogu i rregullt politik ndërmjet BE-së dhe Turqisë ka vazhduar të intensifikohet, duke mbuluar si çështjet ndërkombëtare me interes të përbashkët siç janë Lindja e Mesme dhe Azia Qendrore ashtu edhe çështjet globale siç janë kundër-terrorizmi dhe mospërhapja e tij. Turqia ka vazhduar politikën e vet të angazhimit në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe përmes pjesëmarrjes së saj aktive në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore dhe kontributin e saj në misionet ushtarake, policore dhe të sundimit të ligjit të udhëhequra nga BE-ja në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë.

Turqia ka vazhduar të shprehë mbështetje për rifillimin e bisedimeve që synojnë arritjen e një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe zgjidhjen e qëndrueshme të *çështjes së Qipros* nën mbështetjen e zyrave të Kombeve të Bashkuara. Gatishmëria e Turqisë dhe Greqisë të pranojnë kontaktet me kryenegociatorët e të dy komuniteteve është një hap pozitiv që potencialisht mund të mbështesë procesin e zgjidhjes.

BE-ja gjithashtu ka theksuar rëndësinë e progresit në normalizimin e marrëdhënieve midis Turqisë dhe të gjitha shteteve anëtare të BE-së, duke përfshirë Republikën e Qipros. Në këtë drejtim, BE-ja i ka bërë thirrje Turqisë që të ndërpres bllokimin e anëtarësimit të Shteteve Anëtare në organizatat dhe mekanizmat ndërkombëtarë. Për më tepër, BE-ja përsëri ka theksuar të gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së, të cilat përfshijnë, ndër të tjera: lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe, si dhe për të eksploruar dhe shfrytëzuar burimet e tyre natyrore, në përputhje me *acquis-in e* BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e OKB-së mbi Ligjin Detar.

Në këtë kontekst, në konkluzionet e Këshillit të datës 11 dhjetor 2012, BE-ja vuri në dukje me keqardhje të thellë se Turqia, përkundër thirrjeve të përsëritura, vazhdon të refuzojë përmbushjen e detyrimit të saj që ka për zbatim të plotë jo-diskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit kundrejt të gjitha Shteteve Anëtare dhe se nuk i ka hequr të gjitha kufizimet ndaj anijeve dhe avionëve, të regjistruar në Qipro apo të cilat destinacionin e fundit e kishin portin në Qipro. BE-ja ka theksuar se përmbushja e këtij detyrimi mund t'i japë shtysë të rëndësishme procesit të negociatave. Në mungesë të progresit në këtë çështje, BE-ja do të mbajë masat e saj nga viti 2006, që do të kenë një efekt të vazhdueshëm mbi progresin e përgjithshëm të negociatave. BE-ja do të vazhdojë të ndjekë nga afër dhe të shqyrtojë përparimin e bërë në të gjitha çështjet e përcaktuara në deklaratën e Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të saj të datës 21 shtator 2005. Tani pritet përparim pa ndonjë vonesë të mëtejshme.

Në përputhje me Kornizën Negociuese dhe konkluzionet e mëparshme të Këshillit Evropian dhe të Këshillit, Turqia duhet të angazhohet pa mëdyshje për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, t'i drejtohet nëse është e nevojshme, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këtë kontekst, BE-ja edhe njëherë ka shprehur shqetësimin serioz dhe i ka kërkuar Turqisë që t'i shmanget çdo lloj kërcënimi ose veprim drejtuar kundër një Shteti Anëtar, ose ndonjë lloj fërkimi ose veprimi, të cilat mund të dëmtojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore si dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

BE-ja ka përshëndetur faktin se janë duke vazhduar nismat e bashkëpunimit midis Greqisë dhe Turqisë për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe. Në shtator u mbajt raundi i fundit i 55-të i bisedimeve paraprake për caktimin e kufijve të cektinës kontinentale. Greqia dhe Qiproja i

parashtruan ankesat formale në lidhje me shkeljen e ujërave të tyre territoriale dhe të hapësirës së tyre ajrore nga Turqia, duke përfshirë fluturimet mbi ishujt grek.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Turqia është një ekonomi funksionale e tregut. Ajo do të duhej të jetë në gjendje të përballet me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në një periudhë afatmesme, me kusht që ajo të përshpejton zbatimin e programit të saj gjithëpërfshirës të reformave strukturore.

Pas normave të mëdha të rritjes prej rreth 9% në dy vitet e kaluara, rritja e BPV-së së Turqisë u ngadalësua në 2.2% në vitin 2012. Kjo u shoqërua me një rebalancim të rritjes së kërkesës së brendshme për tregtinë e jashtme, një ngushtim i përkohshëm i deficitit të llogarisë rrjedhëse, dhe një rënie e inflacionit. Në gjysmën e parë të vitit 2013, rritja e BPV-së u forcua sërish në 3.7%. Në të njëjtën kohë, deficit i llogarisë rrjedhëse u zgjerua përsëri dhe çmimet e konsumit janë ri- përshpejtuar. Borxhi publik si pjesë e BPV-së ka vazhduar të ulet dhe tani është qartësisht nën 40%. Që nga maji, për shkak të faktorëve të brendshëm dhe global, tregjet financiare kanë ardhur nën presionin që dërgoi në reagime të menjëhershme nga banka qendrore me qëllim të stabilizimit të kursit të këmbimit dhe frenimit të flukseve dalëse të kapitalit.

Performanca ekonomike kohëve të fundit e Turqisë ilustron si potencialin e lartë ashtu edhe mosbalancimet e vazhdueshme të ekonomisë. Nga ana e jashtme, mbështetja në flukset e qëndrueshme hyrëse të kapitalit për të financuar deficitin e madh strukturor të llogarisë rrjedhëse e bënë Turqinë të rrezikuar ndaj ndryshimeve globale të rrezikut, duke rezultuar në luhatjet e mëdha të kursit të këmbimit dhe cikleve të përshpejtuara rrënuese të aktivitetit ekonomik. Adresimi i kësaj rrezikshmërie kërkon aplikimin e masave për të rritur kursimin kombëtar dhe politikën fiskale dhe këto luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Miratimi i një rregulle fiskale do të rrisë transparencën e buxhetit, do të sigurojë një mbështetje të rëndësishme fiskale dhe do të rrisë besueshmërinë. Inflacioni relativisht i lartë vazhdon të jetë një sfidë e madhe. Ribalancimi i politikës mikse makroekonomike do të jetë i dobishëm për të lehtësuar barrën mbi politikën monetare. Për periudhën nga afatmesme në afatgjatë, është thelbësore që të përmirësohet funksionimi i tregjeve të mallrave, shërbimeve dhe punës nëpërmjet reformave strukturore për të rritur konkurrencën ndërkombëtare.

Sondazhi në vazhdim e sipër mbi funksionimin e **Unionit Doganor BE-Turqi** ofron një mundësi të rëndësishme për të reflektuar dhe diskutuar mbi modernizimin e nevojshëm të këtij instrumenti kyç në marrëdhëniet BE-Turqi, me qëllim të ri- fuqizimit të performancës së tregtisë në të dyja anët dhe integritet ekonomik.

Duke pasur parasysh potencialin për zhvillim të mëtejshëm të Turqisë si një qendër energjetike si dhe sfidat e përbashkëta që Turqia i ndan me BE-në, është e rëndësishme që dialogu i shtuar të zhvillohet në të gjitha çështjet me interesit të përbashkët.

Për sa i përket **aftësisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, Turqia ka vazhduar të bëjë përafrime me *acquis-in*. Ka pasur progres të mirë në lëvizjen e lirë të mallrave; shërbimeve financiare, energjisë; politikave rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore; shkencë dhe hulumtim; dhe arsim. Ka pasur zhvillime të rëndësishme në krijimin e kornizës ligjore në fushën e migracionit dhe azilit. Korniza ligjore kundër financimit të terrorizmit është përmirësuar. Legjislacioni i ri për energjinë elektrike ka sjellë këtë fushë në një masë të madhe në përputhje me *acquis-in*. Komisioni ka vlerësuar progresin e bërë në kornizë të grupeve punuese në kuadër të Agjendës Pozitive dhe ka informuar Turqinë dhe Shtetet Anëtare se cilat janë ato Standarde që duhet të plotësohen. Komisioni gjithashtu e pranoi përparimin e arritur në kërkesat e rëndësishme sa i përket gjyqësorit dhe të drejtave themelore. Progresi ka qenë i kufizuar në disa kapituj, duke përfshirë prokurimin publik, politikën e konkurrencës, bujqësinë dhe zhvillimin rural, sigurinë e ushqimit, politikat veterinarë dhe fito-sanitare si dhe tatueshmërinë.

Duhet të vazhdojnë përpjekjet gjithëpërfshirëse në fushën e ligjit mbi pronësinë intelektuale, bujqësinë dhe zhvillimin rural, sigurinë e ushqimit, politikat veterinarë dhe fito-sanitare,

politikën sociale dhe të punësimit, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, si dhe mbrojtjen e konsumatorit. Progres i mëtejshëm i rëndësishëm është i nevojshëm në gjyqësorin dhe të drejtat themelore të njeriut dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Duhet të vazhdohet përafrimi legjislativ sidomos në prokurimin publik, politikat e konkurrencës dhe tatimit. Turqia ka nevojë të zhvillojë kapacitetet e saja institucionale, në veçanti nën kapitujt e ligjit mbi kompanitë, transportin si dhe politikës rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore.

## **Islanda**

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të 27 prillit të vitit 2013, qeveria ka vendosur që t'i mbajë pezull negociatat për anëtarësim në BE dhe ka bërë të ditur se negociatat nuk do të vazhdohen nëse nuk miratohet nëpërmjet një referendumi. Komisioni i Islandës për negociim me BE-në është shpërbërë. Ky vendim do të thotë se procesi i anëtarësimit është ndalur. Qeveria ka deklaruar se do të ndërmarr një vlerësim të statusit të negociatave të deritanishme si dhe mbi zhvillimet në Bashkimin Evropian, i cili do t'i dorëzohet parlamentit Islandez për diskutim në muajt e ardhshëm.

Autoritetet Islandeze nën qeverinë e re kanë ndërprerë kontributin e tyre për këtë raport. Raportimi i Komisionit në kornizën e kësaj Komunikate është përshtatur për të pasqyruar këtë fakt, ku periudha e mbuluar është nga shtatori i vitit 2012 deri në hyrjen në fuqi të qeverisë së re në maj të vitit 2013.

Deri më tani, janë hapur 27 kapitujt e bisedimeve, nga të cilat 11 janë mbyllur përkohësisht. Progres i konsiderueshëm është bërë në këtë drejtim gjatë periudhës raportuese me 9 kapitujt të hapur dhe me 1 të mbyllur përkohësisht. Islanda është një partner i rëndësishëm për BE-në për shkak të anëtarësimit të saj në Zonën Ekonomike Evropiane dhe pjesëmarrjes së saj në Zonën Shengen, gjithashtu, për shkak të interesave të përbashkëta në fushat e energjisë së rinovueshme dhe të ndryshimeve klimatike si dhe në aspektin e rëndësishëm strategjik për politikën Arktike të BE-së.

Si një demokraci e vendosur mirë dhe funksionale, Islanda vazhdon të përmbushë plotësisht **kriteret politike** për anëtarësim në BE .

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Islanda mund të konsiderohet si një ekonomi funksionale e tregut. Kufizimet në lëvizjen e kapitalit janë një pengesë e konsiderueshme për investim dhe zhvillim. Mbetet një sfidë kryesore heqja e këtyre kontrolleve duke ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit. Një grup ad-hoc për heqjen e kontrolleve të kapitalit, duke përfshirë ekspertë nga Banka Qendrore Evropiane, Komisioni dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ishte themeluar në qershor të vitit 2012 me kërkesë të qeverisë Islandeze, në kuadër të kornizës së anëtarësimit, për të vlerësuar perspektivat për heqjen e këtyre kontrolleve.

Sa i përket **Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA)** për Islandën, duke marrë parasysh qëllimin e këtij instrumenti dhe vendimin e qeverisë mbi negociatat për anëtarësim, Komisioni e ka pezulluar punën përgatitore për IPA II. Komisioni nuk do të nënshkruajë ndonjë kontratë të re nën IPA I. Sa i përket projekteve për të cilat kontratat tashmë janë nënshkruar, Komisioni po e bën një vlerësim projekt-për-projekt së bashku me autoritetet Islandeze në mënyrë që Komisioni të përcaktojë se cilat projekte do të vazhdohen.

Islanda tashmë ka arritur një **nivel të lartë të përafrimit** në një numër të konsiderueshëm të fushave të politikave që mbulohen nga *acquis-i*, kryesisht për shkak të anëtarësimit të saj në Zonën Ekonomike Evropiane. Janë bërë hapa shtesë drejt përafrimit në periudhën e raportimit, duke përfshirë fushat e politikave në vijim: lëvizjen e lirë të mallrave, ligjin mbi kompanitë, prokurimin publik, shoqërinë informative, mediat dhe politikën e transportit.